INSTITUTI
DEMOKRATIK
I KOSOVËS

# TRANSPAROMETRI KOMUNAL 2018

JANAR 2019, PRISHTINË



# TRANSPAROMETRI KOMUNAL 2018

(DRAGASH, DRENAS, GRAÇANICË, KAMENICË, KLINË, MALISHEVË, MAMUSHË, MITROVICË E JUGUT, OBILIQ, SHTËRPCË, VITI)

JANAR 2019, PRISHTINË

COPYRIGHT © 2019. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,
10000, Prishtinë, Kosovë.

Tel.: +381 (0)38 248 038

E-mail: info@kdi-kosova.org

Web: www.kdi-kosova.org

Layout and design: **envinion**

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Ambasadës Britanike në Prishtinë. Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

# PËRMBAJTJA


HYRJE ........................................ 6

METODOLOGJIA ............................ 7

Indikatorët dhe shtyllat ........... 7

Matja.................................... 10

DRENASI .................................... 11

MITROVICA E JUGUT .................. 19

VITI......................................... 27

MALISHEVË ............................... 35

KLINA...................................... 43

DRAGASH ................................. 51

KAMENICA................................ 59

SHTËRPCE ................................ 67

GRAÇANICA ............................... 75

OBILIQ ..................................... 83

MAMUSHË ................................. 91

REKOMANDIMET......................... 99

# HYRJE

Transparenca dhe llogaridhënia e insititucioneve publike është një nga parakushtet kyçe për funksionimin e një shteti dhe shoqërie demokratike. Transparenca e institucioneve publike ndikon direkt në mënyrën e funksionimit të qeverisjes dhe rrjedhimisht përmirëson jetën e qytetarëve. Veç kësaj, transparenca institucionale inkurajon ndërveprimin dhe marrëdhëniet ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve, duke u mundësuar grupeve të margjinalizuara pjesëmarrje në vendimmarrje. Institucionet lokale shërbejnë si mekanizëm i parë ku qytetari adreson shqetësimet dhe parashtron kërkesat për zgjidhjen e problemeve ditore që përbëjnë jetën e një komuniteti në komuna[1]. Rrjedhimisht, janë pikërisht këto institucione, të cilat transparencën duhet ta kenë primare në agjendën e tyre në mënyrë që ta ngrisin pjesëmarrjen qytetare dhe ta përmirësojnë performancën.

Transparenca institucionale u mundëson qytetarëve që të kenë qasje në informacione të rëndësishme publike, por mbi të gjitha të ndihen hisedarë në qeverisje. Rrjedhimisht, ajo ofron mekanizma për luftimin e dukurive negative që mund ta dëmtojë jetën e përditshme të tyre. Qasja në informacion është mjet i fuqishëm dhe i nevojshëm për të parandaluar vendimet e dëmshme, korrupsionin dhe keqpërdorimet me resurset publike.

Niveli i ulët i transparencës ndikon negativisht në jetën e qytetarëve ashtu sikurse edhe në vitalitetin dhe funksionimin e institucioneve të qeverisjes lokale.

Korniza ligjore e Republikës së Kosovës garanton institucione transparente karshi qytetarëve të saj. Kushtetuta, ligji për vetëqeverisjen lokale, ligji për qasje në dokumente publike, si dhe udhëzime të tjera administrative legjitimojnë këtë garancion si dhe sigurojnë qytetarët me mjetet e nevojshme ligjore për të kërkuar transparencë dhe llogaridhënie nga institucionet e qeverisjes lokale në Kosovë.

Duke u bazuar në rëndësinë e transparencës dhe bazën ekzistuese ligjore, KDI-ja ka zhvilluar matjen e transparencës në 11 komuna. Kjo matje është zhvilluar në një periudhë të caktur kohore dhe ka për qëllim pasqyrimin e rezultateve të komunave si hap i parë drejt ngritjes së mëtutjeshme të nivelit të transparencës.

KDI-ja shpreson që rezultatet e Transparometrit do të shërbejnë si udhërrëfyes dhe motivim për ngritjen e transparencës së institucioneve lokale karshi qytetarëve, avancimin e proceseve vendimmarrëse përmes bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes qytetare. Mbi të gjitha përmirësimin e shërbimeve për qytetarët e komunave përkatëse.

1 KDI, "Transparometri komunal", 2017. http://kdi-kosova.org/ëp-content/uploads/2018/02/Transparometri-ALB-ALL-SMALL_Fin.pdf

# METODOLOGJIA

Hulumtimi është realizuar në 11 komuna të Kosovës: Mitrovicë e Jugut, Obiliq, Drenas, Malishevë, Klinë, Mamushë, Dragash, Shtërpcë, Graçanicë, Viti dhe Kamenicë.

Periudha e realizimit të hulumtimit është ndërmjet muajve shtator–dhjetor 2018. Kurse verifikimi i të dhënave në uebfaqet e komunave, intervistat me akterë komunalë dhe kërkesat për qasje në dokumente publike janë bërë gjatë periudhës nëntor– dhjetor 2018.

# INDIKATORËT DHE SHTYLLAT

Performansa e të gjitha qyteteve/komunave matet me rreth 59 tregues të përcaktuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), duke u bazuar në përvojat paraprake rreth indeksit të transparencës së komunave në Kosovë dhe transparometrit. Kjo, gjithnjë duke u përshtatur me legjislacionin aktual në Kosovë, i cili ka të bëjë me 4 fusha (shtylla): Kuvendi Komunal, zyra e kryetarit të komunës, financat e komunës dhe konsultimet me pubikun.

## Indikatorët për Kuvendin Komunal:

1. A janë të publikuara materialet e nevojshme për thirrje të seancës?(procesverbalet nga mbledhja e kaluar, pikat e rendit të ditës, materiali për shqyrtim)?
2. A ekziston një databazë, mekanizëm ku publikohen ose mund të sigurohet qasja në rregulloret e shqyrtuara, aprovuara dhe mënyrën e votimit?
3. A janë të publikuara të dhënat biografike, kontaktet dhe kompetencat e anëtarëve të Kuvendit Komunal?
4. A ka një historik të shkurtër me të dhëna kryesore në ballinë të uebfaqes që shërbejnë si letërnjoftim për Komunën?
5. A mund të gjenden lehtë informacione mbi procesin e ligjbërjes, politikbërjes, dhe vendimmarrjes, në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar mbi ato procese?
6. A është bërë informimi i qytetarëve për takime në kohën e caktuar sipas rregullores së Kuvendit, dhe në lokacionet e parapara: shpalljet publike në vendet më të frekuentuara, media dhe uebfaqe.
7. A janë mbledhjet e komiteteve të hapura për publikun?
8. A mund të gjenden lehtë kontaktet dhe të dhënat për institucionet publike të komunës (institucionet parashkollore, shtëpitë e shëndetit, etj.)?

9. A janë mbajtur të gjitha seancat e rregullta të para-para me ligj (10 prej tyre)?
10. A është publik organogrami i komunës?
11. A monitorohen mbledhjet e KK-së, nga organizata të shoqërisë civile?
12. A e ka të publikuar Kuvendi planin e Punës?
13. A ka KK-ja plan të veprimit për Transparencë dhe a është publik?
14. A publikohen linqe të videove pas seancave të Ku-vendit?
15. A ka qasje në draftrregulloret dhe planet e KK-së?
16. A ka qasje në procesverbale?
17. A ka qasje në rendin e ditës?
18. A ka qasje në rregullore dhe vendime të KK-së?
19. A janë seancat e hapura për publikun?
20. A transmetohen seancat e Kuvendit drejtëpërdejtë, nëse po në çfarë platforme?

## Indikatorët për zyren e kryetarit

1. A janë të publikuara detajet biografike të Kryetarit/res dhe drejtorëve/eshave (email, nr. kontaktues, biografi etj)?
2. A ekzistojnë informata për çështjet që ndërlidhen me integrimet në BE dhe ndikimet e procesit në komunë?
3. A janë konkurset e punësimit dhe kriteret të publikuara dhe transparente për qytetarët?
4. A ka koordinator/e për qasje në dokumente zyrtare si dhe databazë me numrin e kërkesave dhe trajtimin e tyre?
5. A ekziston një mekanizëm përcjellës për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve dhe statutit të kërkesave të tyre (a është publike)?
6. Si qëndron niveli i përgjigjeve për qasje në dokumente zyrtare
7. A janë të publikuara Planet Zhvillimore të komunës?
8. A është publik plani i punës të Kryetarit/res?
9. A është publikuar raporti gjashtëmujori i punës?
10. A është realizuar raporti i Kryetarit/res në Kuvend dhe komisione (raporti i punës 2 herë në vit)?
11. A zhvillohen raportimet e drejtorëve/eshave në kuvend dhe komisione siç është paraparë?
12. A ka komuna rregullore për ngacmime seksuale?
13. A është uebfaqja e qasshme në të gjitha gjuhet zyrtare të Komunës?
14. A janë vendimet e Kryetarit/res të Komunës publike dhe të qasshme për publikun
15. A ka informacione nga vizitat javore të Kryetarit/res?

# Indikatorët për financat e komunës

1. A është publik borxhi publik komunal dhe borxhi i kompanive ndaj komunës?
2. A janë mbajtur diskutime brenda afateve ligjore mbi shpenzimet tre-mujore në Kuvend?
3. A është publike lista e pronave të lëshuara me qera nga Komuna?
4. A ka një mekanizëm që shënon regjistrimin e propozimeve të qytetarëve rreth buxhetit?
5. Si informohen qytetarët për pjesëmarrje në takimet e Komitetit për Financa?
6. A ka qasje në informata rreth ndryshimeve buxhetore të miratuara nga KK
7. A ka informata rreth përgjigjeve që komuna i bënë ndaj kërkesave buxhetore të qytetarëve?
8. A ka të dhëna mbi të hyrat vetjake të Komunës?

# Indikatorët për konsultimet me publikun

1. Si është bërë dhe si është monitoruar adresimi i ankesave të qytetarëve?
2. A është bërë hapja e të dhënave statistikore "Open Data"?
3. A ka dhe si mund të gjinden informata rreth publikimeve të memorandumeve me OSHC-në?
4. A përdor Komuna rrjete sociale në baza të rregullta?
5. A është bërë konsolidimi i bashkësive lokale dhe a ka informata publike rreth tyre?
6. A janë të publikuara kontaktet e zyrtarit/res dhe zyrës për informim?
7. A ka një linjë direkte pa pagesë për qytetarët?
8. A ekziston një listë e hollësishme të shërbimeve që institucionet ofrojnë për publikun?
9. A ka materiale përcjellëse për qytetarët për dëgjimet publike dhe buxhetore?
10. A përkthehen materialet në të gjitha gjuhët zyrtare?
11. A bëhen njoftimet për takime publike edhe në forma tradicionale? Nëse po, në çfarë formash?
12. A janë organizuar takimet publike ashtu siç janë të parapara me ligj?
13. A bëhet publikimi i aktiviteteve në ballinën e uebfaqes?
14. A publikohen raportet për transparencë (të realizuara për komunën përkatëse nga akterë të tjerë të shoqërisë civile a tjetër)?
15. A publikohen raportet nga konsultimet me publikun dhe dëgjimet për buxhet?
16. A organizohen takime me organizata të shoqërisë civile?

# MATJA

Hulumtimi është bërë në bazë të pranisë të së dhënave në uebfaqen zyrtare të komunave, përgjigjet në pyetjet zyrtare drejtuar autoriteteve lokale, si dhe monitorimit të punës së autoriteve komunale. Në kuadër të matjes, janë realizuar **24** intervista me zyrtarë për informim dhe drejtor të finacave dhe buxhetit, janë dërguar **24** kërkesa për qasje në dokumente zyrtare, mbi **20** seanca të monitoruara në kuvende komunale si dhe analiza e uebfaqeve të **11** komunave.

## Metoda e vlerësimit e përdorur për të dhënë një numër të caktuar pikësh

Për të vlerësuar me pikë, janë përdorur disa metoda: sigurimi i standardeve të pajtueshmërisë të miratuara nga UA 01/2015 i MAPL[2], UA 01/2015 i MAP[3], Ligji nr. 03/L-040[4], Ligji nr. 03/L-048[5], dhe Vendimi i Qeverisë nr. 07/87[6]; Rregullorja e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 04/2015[7]; analiza e uebfaqes dhe konkludimi analitik i ekipit hulumtues. Hulumtimi tregon qartë se ekziston informacion i mjaftueshëm në uebfaqen zyrtare ose në burime të tjera zyrtare të internetit, përgjigja në letrën e kërkimit të informacionit si dhe intervista me zyrtarë komunal.

# Poentimi

Rezultati maksimal për një komunë, përfshirë të gjitha shtyllat (me gjithsejt 59 inidikatorë) është 118 pikë, ku:

## Poentimi i suksesit do të jetë:

**118** PIKË - komuna më transparente

**0** PIKË - komuna më së paku transparente

## Secili indikator (tregues) poentohet prej 0 deri 2 pikë.

**0** PIKË - indikatori nuk është përmbushur (nuk ka asnjë informacion)

**1** PIKË - indikatori është përmbushur pjesërisht (vetëm disa informata janë shpalosur)

**2** PIKË - indikatori është përmbushur (informacioni është shpalosur plotësisht).

2 Udhëzim Administrativ (MAPL) nr. 01/2015 për transparencë në komuna : https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11403

3 Udhëzim Administrativ (MAP) nr. 01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike: https://map.rks-gov.net/getattachment/04a69d9b-2b96-4ef2-bfc7-4c82cb860384/Udhezimi-Administrativ-(MAP)-nr-01-2015-per-Ueb-Fa.aspx

4 Ligji nr. 04 / L-042 për prokurimin publik në Republikën e Kosovës: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772

5 Ligji Nr. 03 / L-040 për vetëqeverisjen lokale: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530

6 Ligji nr. 03 / L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524

7 Vendimi i Qeverisë 07/87 mbi të dhënat e hapura: http://ëëë.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_87-te_te_Qeverise_2016.pdf



# Drenasi

Komuna e Drenasit ka dal të jetë komuna më transparente nga 11 komunat ku është bërë monitorimi dhe hulumtimi. Nga gjithsej 118 pikë, komuna e Drenasit ka marr 97 pikë. Niveli i transparencës së përgjithshme në përqindje është 82.22% nga 59 indikatorë të përzgjedhur.

Më poshtë gjeni tabelën me të dhënat për poentimin sipas shtyllave. Gjithashtu janë prezantuar të dhënat për secilën nga shtyllat ku është bërë monitorimi dhe hulumtimi.

97 PIKË

82.22%



# Drenasi


40
32
30
23
16
14
32
28
Kuvendi komunal
Zyra e kryetarit të komunës
Financat e komunës
Konsultime me Publikun

## Indikatorët për Kuvendin Komunal:

| | PIKËT |
|---|---|
| 1. A janë të publikuara materialet e nevojshme për thirrje të seancës?(procesverbalet nga mbledhja e kaluar, pikat e rendit të ditës, materiali për shqyrtim)? | 2 |
| 2. A ekziston një databazë, mekanizëm ku publikohen ose mund të sigurohet qasja në rregulloret e shqyrtuara, aprovuara dhe mënyrën e votimit? | 1 |
| 3. A janë të publikuara të dhënat biografike, kontaktet dhe kompetencat e anëtarëve të Kuvendit Komunal? | 1 |
| 4. A ka një historik të shkurtër me të dhëna kryesore në ballinë të uebfaqes që shërbejnë si letërnjoftim për Komunën? | 0 |
| 5. A mund të gjenden lehtë informacione mbi procesin e ligjbërjes, politikbërjes, dhe vendimmarrjes, në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar mbi ato procese? | 2 |
| 6. A është bërë informimi i qytetarëve për takime në kohën e caktuar sipas rregullores së Kuvendit, dhe në lokacionet e parapara: shpalljet publike në vendet më të frekuentuara, media dhe uebfaqe. | 2 |
| 7. A janë mbledhjet e komiteteve të hapura për publikun? | 2 |
| 8. A mund të gjenden lehtë kontaktet dhe të dhënat për institucionet publike të komunës (institucionet parashkollore, shtëpitë e shëndetit, etj.)? | 0 |
| 9. A janë mbajtur të gjitha seancat e rregullta të parapara me ligj (10 prej tyre)? | 2 |
| 10. A është publik organogrami i komunës? | 0 |
| 11. A monitorohen mbledhjet e KK-së, nga organizata të shoqërisë civile | 2 |
| 12. A e ka të publikuar Kuvendi planin e Punës? | 2 |
| 13. A ka KK-ja plan të veprimit për Transparencë dhe a është publik? | 2 |
| 14. A publikohen linqe të videove pas seancave të Kuvendit? | 2 |
| 15. A ka qasje në draftrregulloret dhe planet e KK-së? | 2 |
| 16. A ka qasje në procesverbale? | 2 |
| 17. A ka qasje në rendin e ditës? | 2 |
| 18. A ka qasje në rregullore dhe vendime të KK-së? | 2 |
| 19. A janë seancat e hapura për publikun? | 2 |
| 20. A transmetohen seancat e Kuvendit drejtëpërdejtë, nëse po në çfarë platforme? | 2 |

## Zyra e kryetarit të komunës

| | |
|---|---|
| 1. A janë të publikuara detajet biografike të Kryetarit/res dhe drejtorëve/eshave (email, nr. kontaktues, biografi etj)? | 2 |
| 2. A ekzistojnë informata për çështjet që ndërlidhen me integrimet në BE dhe ndikimet e procesit në komunë? | 0 |
| 3. A janë konkurset e punësimit dhe kriteret të publikuara dhe transparente për qytetarët? | 2 |
| 4. A ka koordinator/e për qasje në dokumente zyrtare si dhe databazë me numrin e kërkesave dhe trajtimin e tyre? | 2 |
| 5. A ekziston një mekanizëm përcjellës për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve dhe statutit të kërkesave të tyre (a është publike)? | 2 |
| 6 . Si qëndron niveli i përgjigjeve për qasje në dokumente zyrtare | 2 |
| 7. A janë të publikuara Planet Zhvillimore të komunës? | 0 |
| 8. A është publik plani i punës të Kryetarit/res? | 2 |
| 9. A është publikuar raporti gjashtëmujori i punës? | 2 |
| 10. A është realizuar raporti i Kryetarit/res në Kuvend dhe komisione (raporti i punës 2 herë në vit)? | 2 |
| 11. A zhvillohen raportimet e drejtorëve/eshave në kuvend dhe komisione siç është paraparë? | 2 |
| 12. A ka komuna rregullore për ngacmime seksuale? | 0 |
| 13. A është uebfaqja e qasshme në të gjitha gjuhet zyrtare të Komunës? | 1 |
| 14. A janë vendimet e Kryetarit/res të Komunës publike dhe të qasshme për publikun? | 2 |
| 15. A ka informacione nga vizitat javore të Kryetarit/res? | 2 |

## Financat e komunës

| | |
|---|---|
| 1. A është publik borxhi publik komunal dhe borxhi i kompanive ndaj komunës? | 2 |
| 2. A janë mbajtur diskutime brenda afateve ligjore mbi shpenzimet tre-mujore në Kuvend? | 2 |
| 3. A është publike lista e pronave të lëshuara me qera nga Komuna? | 2 |
| 4. A ka një mekanizëm që shënon regjistrimin e propozimeve të qytetarëve rreth buxhetit? | 2 |
| 5. Si informohen qytetarët për pjesëmarrje në takimet e Komitetit për Financa? | 2 |
| 6. A ka qasje në informata rreth ndryshimeve buxhetore të miratuara nga KK? | 2 |
| 7. A ka informata rreth përgjigjeve që komuna i bënë ndaj kërkesave buxhetore të qytetarëve? | 0 |
| 8. A ka të dhëna mbi të hyrat vetjake të Komunës? | 2 |

## Konsultime me Publikun

| | |
|---|---|
| 1. Si është bërë dhe si është monitoruar adresimi i ankesave të qytetarëve? | 2 |
| 2. A është bërë hapja e të dhënave statistikore "Open Data"? | 0 |
| 3. A ka dhe si mund të gjinden informata rreth publikimeve të memorandumeve me OSHC-në? | 2 |
| 4. A përdor Komuna rrjete sociale në baza të rregullta? | 2 |
| 5. A është bërë konsolidimi i bashkësive lokale dhe a ka informata publike rreth tyre? | 1 |
| 6. A janë të publikuara kontaktet e zyrtarit/res dhe zyrës për informim? | 2 |
| 7. A ka një linjë direkte pa pagesë për qytetarët? | 2 |
| 8. A ekziston një listë e hollësishme të shërbimeve që institucionet ofrojnë për publikun? | 2 |
| 9. A ka materiale përcjellëse për qytetarët për dëgjimet publike dhe buxhetore? | 2 |
| 10. A përkthehen materialet në të gjitha gjuhët zyrtare? | 1 |
| 11. A bëhen njoftimet për takime publike edhe në forma tradicionale? Nëse po, në çfarë formash? | 2 |
| 12. A janë organizuar takimet publike ashtu siç janë të parapara me ligj? | 2 |
| 13. A bëhet publikimi i aktiviteteve në ballinën e uebfaqes? | 2 |
| 14. A publikohen raportet për transparencë (të realizuara për komunën përkatëse nga akterë të tjerë të shoqërisë civile a tjetër)? | 2 |
| 15. A publikohen raportet nga konsultimet me publikun dhe dëgjimet për buxhet? | 2 |
| 16. A organizohen takime me organizata të shoqërisë civile? | 2 |

Komuna e Drenasit

# Kuvendi Komunal

32

**Kuvendi komunal i Drenasit është vlerësuar me pikë maksimale në 15 indikatorë prej 20 sa janë matur gjithsej. Pra nga gjithsej 40 pikë në këtë shtyllë, Drenasi ka marr 32 sosh Në dy indikatorë të tjerë në këtë shtyllë, është vlerësuar me nga një pikë, teksa në 3 të tjera me zero.**

## TË ARRITURAT

Kuvendi Komunal i Drenasit i bënë të gjitha publikimet e agjendave dhe rendit të ditës për seancat e mbajtura. Procesverbalet janë të publikuara bashkë me rregulloret e shqyrtuara, mënyrën e aprovimit të pikave të rendit si dhe votimi në këto seanca.

Në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar rreth proceseve dhe mënyrës së bërjes politikave është publikuar edhe procesi i ligjbërës dhe vendimmarrjes. Qytetarët gjithashtu janë të informuar me kohë rreth mbledhjeve të Kuvendit Komunal, ndërkohë që shpalljet publikohen në vende të frekuentuara. Kuvendi Komunal i Drenasit i ka mbajtur 10 seanca të rregullta, sa ishin të planifikuara për vitin 2018. Të gjitha janë monitoruar nga organizatata shoqërisë civile. Plani i veprimit të transparencës është publikuar në uebfaqen e komunës.

Video linqet e mbledhjeve të seancave të Kuvendit Komunal janë të publikuara në kanalin zyrtar të komunës, në rrjetin social në "YouTube". Po ashtu ekziston qasja edhe në procesverbalet, rendin e ditës si dhe rregulloret dhe vendimet që i merr Kuvendi Komunal i Drenasit.

Seancat e kuvendit komunal e po ashtu edhe Komiteti për Politikë dhe Financa janë të hapura për publikun, ndërkaq seancat transmetohen drejtpërdrejtë në uebfaqen e komunës.

## NGECJET

Kuvendi Komunal i Drenasit në 1 indikator është poentuar me 1 pikë, ndërsa në 2 të tjerë kanë marr zero pikë. Për dallim nga komunat tjera, në uebfaqen e komunës së Drenasit, janë të vendosura të dhënat për kontakte të anëtarëve të Kuvendit Komunal, mirëpo nuk janë të vendosura të dhënat mbi përgjegjësitë e tyre. Po ashtu nuk ka informacione për të dhënat e institucioneve publike që janë në mbikëqyrje të Kuvendit komunal. Gjithashtu, nuk është publikuar organogrami i komunës, sikurse nuk ka informacione as mbi historikun e komunës.

Komuna e Drenasit

# Zyra e kryetarit

23

Nga 15 indikatorët e transparencës në zyrën e kryetarit të komunës së Drenasit, 11 kanë marrë pikët maksimale. Ndryshe, nga gjithsej 30 pikë sa ishte maksimumi, zyra e kryetarit të Drenasit ka marrë 23 pikë.

## TË ARRITURAT

Përparim ka në publikimin e detajeve biografike dhe të dhënave kontaktuese për kryetarin dhe administratën. Kriteret e punësimit, si  detajet e konkurseve janë të publikuara për pozitat e caktuara që i shpall komuna. Komuna e Drenasit ka caktuar zyrtarin për shqyrtim fillestar të kërkesave për qasje në dokumentet publike. Ai është edhe zëdhënës i komunës. Secila kërkesë është evidentuar me numrin e saj rendor. Nga 49 kërkesa të paraqitura të gjitha kanë marrë përgjigje. Po ashtu, ekziston mundësia që kërkesat të procedohen nëpërmjet intranetit, porse qasja në të nuk është publike. Plani i veprimit i kryetarit të Komunës si dhe raporti i punës janë të publikuara. Raportimi i drejtorëve dhe drejtoreshave nuk është i veçantë, mirëpo përfshihet në raportin e kryetarit të komunës. Drejtorët raportojnë edhe në komisione, kur ju kërkohet një gjë e tillë.

Takimet e kryetarit dhe informacione për vizitat që ai i bënë, poashtu publikohen në uebfaqen e komunës. Ajo është funksionale dhe në shërbim të të gjithë zyrtarëve.

## NGECJET

Në tre indikatorë të tjerë, zyra e kryetarit ka shënuar pikë minimale pasi që të dhënat e kërkuara nuk janë gjetur në uebfaqen zyrtare të komunës. Kjo përfshin mungesën e informacioneve që kanë të bëjnë me integrimet evropiane, ndonëse edhe pse ka zyrë për integrimet evropiane (Shtylla II, indikatori 2). Ndërkaq, planet zhvillimore të komunës nuk janë të publikuara në uebfaqe (Shtylla II, indikatori 7). Po ashtu nuk është e draftuar dhe e miratuar rregullorja për ngacmime seksuale (Shtylla II, indikatori 12).

Komuna e Drenasit

# Financat e komunës

14

**Komuna e Drenasit ka shënuar rezultat të mirë në shtyllën e financave, duke u vlerësuar me pikë maksimale në shtatë prej gjithsej tetë indikatorëve që janë matur në këtë shtyllë. Ndryshe, nga gjithsej 16 pikë të mundura, kjo shtyllë ka marr 14 prej tyre.**

## TË ARRITURAT

Komuna e Drenasit publikon raportet financiare në të cilat gjendet edhe të hyrat e komunës. Po ashtu kjo komunë ka hartuar edhe raportin mbi borxhin publik të saj, sikurse edhe për borxhet që i kanë palët tjera ndaj saj. Komuna ka listën e pronave të dhëna me qira, të cilat nuk janë publike por mund të sigurohen përmes kërkesës për qasje në dokumente publike. Por, një listë e tillë nuk është vërë në dispozicion të publikut.

Ndryshimet buxhetore që bëhen në Kuvend mund të gjenden në uebfaqen e komunës. Qytetarët informohen për takimet buxhetore, përmes uebfaqes dhe tabelës informuese.

Komuna po ashtu ka një mekanizëm që evidencon kërkesat e qytetarëve gjatë dëgjimeve buxhetore. Një dokument i tillë është ofruar edhe nëpërmjet qasjes në dokumente zyrtare.

Diskutimet tre mujore për shpenzimet e buxhetit po ashtu janë mbajtur.

## NGECJET

Komuna nuk i përgjigjet çdo kërkese buxhetore të qytetarëve.

Komuna e Drenasit

# Konsultimet me publikun

28

Komuna e Drenasit ka dalë me rezultat pozitiv edhe në shtyllën e konsultimeve me publikun. Në 13 prej gjithsej 16 indikatorëve në këtë shtyllë, Drenasi është vlerësuar me pikë maksimale. Në dy indikatorë të tjerë është vlerësuar pjesërisht e në një me zero pikë. Ndryshe, nga gjithsej 32 pikë, kjo shtyllë ka marr 28 sosh.

## TË ARRITURAT

Komuna e Drenasit bënë monitorimin edhe adresimin e ankesave të qytetarëve. Një veprim i tillë është bërë e ditur se bëhet nëpërmjet intranetit dhe Komisionit për Ankesa.

Komuna ofron një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët, sikurse edhe një listë të hollësishme të shërbimeve, të cilat institucionet i ofrojnë për publikun.

Uebfaqja e komunës është aktive dhe në të publikohen informacione të ndryshme. Në mënyrë që këto informacione të arrijnë sa më shumë tek publiku, komuna përdor edhe rrjetet sociale.

Për takimet buxhetore me publikun, komuna ofron materiale përcjellëse. Informimi për takime publike bëhet përmes uebfaqes, por edhe në mënyrë tradicionale, nëpërmjet tabelës informuese.

Të dhënat e zyrtarëve për informim janë të publikuara. Gjithashtu, mbahen takime dhe nënshkruhen memorandume bashkëpunimi me organizata të shoqërisë civile.

## NGECJET

Komuna nuk e  ka bërë hapjen e të dhënave statistikore Open Data. Kjo sipas zyrtarëve komunal nuk është bërë për shkak se procedurat janë ndërprerë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

# Rekomandimet për komunën e Drenasit



Pavarësisht nivelit të lartë të transparencës, komuna e Drenasit duhet të punojë më tutje në ngritjen e nivelit. Më poshtë janë disa rekomandime që kanë dalë nga ky raport.

Komuna e Drenasit duhet të përmirësojë cilësinë e videove të postuara nga mbledhja e Kuvendit Komunal. Aktualisht ato kanë cilësi të dobët, ndaj qytetarët nuk mund të informohen saktë se çfarë është diskutuar në mbledhje.

Komuna duhet të publikojë informacione rreth procesit të plotësimit të kritereve që kërkohen nga komunat për integrim në BE. Kjo pasi Kosova synon integrimin në BE dhe komunat kanë rol të rëndësishëm në këtë proces, sidomos në parandalimin e migrimit të jashtëligjshëm.

Tutje, komuna e Drenasit duhet t`i publikoj në uebfaqen e saj, numrat e kontaktit të institucioneve publike, si: QKMF-së, Zjarrfikësve, institucioneve parashkollore etj.

Orientimit të publikut rreth punës së komunës do t`i ndihmonte edhe publikimi i planeve zhvillimore si dhe publikimi i organogramit të komunës.

Komuna e Drenasit duhet të përmirësojë cilësinë e videove të postuara nga mbledhja e Kuvendit Komunal. Aktualisht ato kanë cilësi të dobët, ndaj qytetarët nuk mund të informohen saktë se çfarë është diskutuar në mbledhje.



# Mitrovica e Jugut

Komuna e Mitrovicës ka dal të jetë komuna e dytë më transparente në kuadër të komunave të zgjedhura për transparometër. Nga gjithsej 118 pikë, kjo komuna ka marr 92 pikë, apo ndryshe në përqindje ka shënuar 77.97%, bazuar në 59 indikatorët e përzgjedhur.

Më poshtë gjeni tabelën me të dhënat për poentimin sipas shtyllave. Gjithashtu, janë të ndara gjetjet për secilën nga shtyllat për të cilat është bërë monitorimi e hulumtimi.

92 PIKË

77.97%



# Mitrovica e Jugut



## Indikatorët për Kuvendin Komunal:

| | PIKËT |
|---|---|
| 1. A janë të publikuara materialet e nevojshme për thirrje të seancës?(procesverbalet nga mbledhja e kaluar, pikat e rendit të ditës, materiali për shqyrtim)? | 2 |
| 2. A ekziston një databazë, mekanizëm ku publikohen ose mund të sigurohet qasja në rregulloret e shqyrtuara, aprovuara dhe mënyrën e votimit? | 1 |
| 3. A janë të publikuara të dhënat biografike, kontaktet dhe kompetencat e anëtarëve të Kuvendit Komunal? | 1 |
| 4. A ka një historik të shkurtër me të dhëna kryesore në ballinë të uebfaqes që shërbejnë si letërnjoftim për Komunën? | 2 |
| 5. A mund të gjenden lehtë informacione mbi procesin e ligjbërjes, politikbërjes, dhe vendimmarrjes, në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar mbi ato procese? | 2 |
| 6. A është bërë informimi i qytetarëve për takime në kohën e caktuar sipas rregullores së Kuvendit, dhe në lokacionet e parapara: shpalljet publike në vendet më të frekuentuara, media dhe uebfaqe. | 2 |
| 7. A janë mbledhjet e komiteteve të hapura për publikun? | 2 |
| 8. A mund të gjenden lehtë kontaktet dhe të dhënat për institucionet publike të komunës (institucionet parashkollore, shtëpitë e shëndetit, etj.)? | 2 |
| 9. A janë mbajtur të gjitha seancat e rregullta të parapara me ligj (10 prej tyre)? | 2 |
| 10. A është publik organogrami i komunës? | 2 |
| 11. A monitorohen mbledhjet e KK-së, nga organizata të shoqërisë civile | 2 |
| 12. A e ka të publikuar Kuvendi planin e Punës? | 2 |
| 13. A ka KK-ja plan të veprimit për Transparencë dhe a është publik? | 1 |
| 14. A publikohen linqe të videove pas seancave të Kuvendit? | 2 |
| 15. A ka qasje në draftrregulloret dhe planet e KK-së? | 0 |
| 16. A ka qasje në procesverbale? | 2 |
| 17. A ka qasje në rendin e ditës? | 2 |
| 18. A ka qasje në rregullore dhe vendime të KK-së? | 2 |
| 19. A janë seancat e hapura për publikun? | 2 |
| 20. A transmetohen seancat e Kuvendit drejtëpërdejtë, nëse po në çfarë platforme? | 2 |

## Zyra e kryetarit të komunës

| | |
|---|---|
| 1. A janë të publikuara detajet biografike të Kryetarit/res dhe drejtorëve/eshave (email, nr. kontaktues, biografi etj)? | 2 |
| 2. A ekzistojnë informata për çështjet që ndërlidhen me integrimet në BE dhe ndikimet e procesit në komunë? | 2 |
| 3. A janë konkurset e punësimit dhe kriteret të publikuara dhe transparente për qytetarët? | 2 |
| 4. A ka koordinator/e për qasje në dokumente zyrtare si dhe databazë me numrin e kërkesave dhe trajtimin e tyre? | 2 |
| 5. A ekziston një mekanizëm përcjellës për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve dhe statutit të kërkesave të tyre (a është publike)? | 2 |
| 6 . Si qëndron niveli i përgjigjeve për qasje në dokumente zyrtare | 2 |
| 7. A janë të publikuara Planet Zhvillimore të komunës? | 2 |
| 8. A është publik plani i punës të Kryetarit/res? | 2 |
| 9. A është publikuar raporti gjashtëmujori i punës? | 0 |
| 10. A është realizuar raporti i Kryetarit/res në Kuvend dhe komisione (raporti i punës 2 herë në vit)? | 0 |
| 11. A zhvillohen raportimet e drejtorëve/eshave në kuvend dhe komisione siç është paraparë? | 2 |
| 12. A ka komuna rregullore për ngacmime seksuale? | 0 |
| 13. A është uebfaqja e qasshme në të gjitha gjuhet zyrtare të Komunës? | 1 |
| 14. A janë vendimet e Kryetarit/res të Komunës publike dhe të qasshme për publikun? | 2 |
| 15. A ka informacione nga vizitat javore të Kryetarit/res? | 2 |

## Financat e komunës

| | |
|---|---|
| 1. A është publik borxhi publik komunal dhe borxhi i kompanive ndaj komunës? | 2 |
| 2. A janë mbajtur diskutime brenda afateve ligjore mbi shpenzimet tre-mujore në Kuvend? | 1 |
| 3. A është publike lista e pronave të lëshuara me qera nga Komuna? | 0 |
| 4. A ka një mekanizëm që shënon regjistrimin e propozimeve të qytetarëve rreth buxhetit? | 0 |
| 5. Si informohen qytetarët për pjesëmarrje në takimet e Komitetit për Financa? | 2 |
| 6. A ka qasje në informata rreth ndryshimeve buxhetore të miratuara nga KK? | 2 |
| 7. A ka informata rreth përgjigjeve që komuna i bënë ndaj kërkesave buxhetore të qytetarëve? | 0 |
| 8. A ka të dhëna mbi të hyrat vetjake të Komunës? | 2 |

## Konsultime me Publikun

| | |
|---|---|
| 1. Si është bërë dhe si është monitoruar adresimi i ankesave të qytetarëve? | 2 |
| 2. A është bërë hapja e të dhënave statistikore "Open Data"? | 0 |
| 3. A ka dhe si mund të gjinden informata rreth publikimeve të memorandumeve me OSHC-në? | 2 |
| 4. A përdor Komuna rrjete sociale në baza të rregullta? | 2 |
| 5. A është bërë konsolidimi i bashkësive lokale dhe a ka informata publike rreth tyre? | 1 |
| 6. A janë të publikuara kontaktet e zyrtarit/res dhe zyrës për informim? | 2 |
| 7. A ka një linjë direkte pa pagesë për qytetarët? | 0 |
| 8. A ekziston një listë e hollësishme të shërbimeve që institucionet ofrojnë për publikun? | 2 |
| 9. A ka materiale përcjellëse për qytetarët për dëgjimet publike dhe buxhetore? | 2 |
| 10. A përkthehen materialet në të gjitha gjuhët zyrtare? | 0 |
| 11. A bëhen njoftimet për takime publike edhe në forma tradicionale? Nëse po, në çfarë formash? | 2 |
| 12. A janë organizuar takimet publike ashtu siç janë të parapara me ligj? | 2 |
| 13. A bëhet publikimi i aktiviteteve në ballinën e uebfaqes? | 2 |
| 14. A publikohen raportet për transparencë (të realizuara për komunën përkatëse nga akterë të tjerë të shoqërisë civile a tjetër)? | 2 |
| 15. A publikohen raportet nga konsultimet me publikun dhe dëgjimet për buxhet? | 2 |
| 16. A organizohen takime me organizata të shoqërisë civile? | 2 |

Komuna e Mitrovicës

# Kuvendi Komunal

35

**Kuvendi Komunal i Mitrovicës është vlerësuar me pikë maksimale në 16 prej gjithsej 20 indikatorëve që janë matur. Pra, në këtë shtyllë komuna e Mitrovicës ka marr 35 pikë nga 40 sa ishin gjithsej.**

## TË ARRITURAT

Kuvendi komunal i Mitrovicës ka bërë një përparim të madh sa i përket publikimit të agjendave dhe rendit të ditës paraprakisht. Kësisoj janë publikuara biografitë e anëtarëve të Kuvendit Komunal si dhe kompetencat e përgjithshme të Kuvendit komunal dhe anëtarëve të tij. Gjithashtu janë të publikuara procesverbalet e mbledhjeve të Kuvendit Komunal, teksa ekziston qasja në rregulloret dhe mënyrën e votimit. Po ashtu mund të gjinden lehtë informacione mbi proceset e vendimmarrjes, politikbërjes dhe ligjbërjes. Në uebfaqen e komunës është i publikuar historiku i komunës dhe të dhënat kryesore për komunën.

Kuvendi Komunal i Mitrovicës ka shënuar përparim në njoftimin me kohë të qytetarëve për mbledhjet dhe takimet e planifikuara. Takimet e komiteteve dhe seancat e Kuvendit Komunal janë të hapura edhe për publikun. Kuvendi komunal i Mitrovicësi ka mbajtur të gjitha 10 seancat të rregullta, të parapara për vitin 2018

## NGECJET

Kuvendi Komunal i Mitrovicës është notuar me pjesërisht në tre indikatorë të tjerë. Që të tre këta indikatorë kanë të bëjnë me publikimin e plotë dhe të veçantë të dokumenteve, si: mungesa e një databaze apo mekanizmi ku mund të sigurohet qasja në shqyrtimin, miratimin dhe aprovimin e rregulloreve (shtylla I, indikatori 2), a janë të publikuara detajet biografike të anëtarëve të Kuvendit Komunal si dhe kompetencat e përgjithshme të Kuvendit Komunal dhe anëtarëve të tij (shtylla I, indikatori 3), plani i transparencës (Shtylla I, Indikatori 13, nëse Kuvendi Komunal ka një plan të veprimit për Transparencë dhe a është publik?), vendimi për të cilin është publikuar, por jo edhe dokumenti si i tillë. Me pikë minimale është vlerësuar qasja në draft rregullore dhe planet e punës (shtylla I, Indikatori 15, nëse ka qasje në draft-rregulloret dhe planet e Kuvendit Komunal).

Komuna e Mitrovicës

# Zyra e kryetarit

23

Nga 15 indikatorë, zyra e kryetarit në komunën e Mitrovicës ka grumbulluar pikë maksimale në 11 prej tyre. Më saktësisht është vlerësuar me 23 pikë nga gjithsej 30 pikë në këtë shtyllë.

## TË ARRITURAT

Zyrja e kryetarit të komunës në Mitrovicë qëndron mirë me 11 nga 15 indikatorët. Është avancuar publikimi i detajeve biografike dhe të dhënave kontaktuese për kryetarin, drejtorët dhe drejtoreshat e komunës. Po ashtu kriteret e punësimit, dhe forma e aplikimit janë të publikuara me kohë dhe të detajuara. Ka informata të mjaftueshme në uebfaqe që ndërlidhen me integrimet evropiane dhe ndikimin e proceseve në komunë. Komuna i trajton të gjitha kërkesat brenda afatit kohorë të paraparë me ligj. Pos raporteve për qasje në dokumente zyrtare të publikuara në uebfaqe, të gjitha kërkesat janë regjistruar në intranet dhe ruhen në mënyrë fizike si dokumente. Gjithashtu janë të publikuara në uebfaqe. Kryetari i komunës e ka të publikuar planin e tij dhe gjithashtu janë të publikuara edhe planet zhvillimore të komunës. Në uebfaqen e komunës janë të publikuara raportet e drejtorëve/eshave të ndara në dy periudha: janar-qershor 2018 dhe korrik-dhjetor 2018. Të gjitha vizitat që i realizon gjatë ditës kryetari mund të gjinden në formë të komunikatave, të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare të Facebook-ut si dhe në uebfaqe të komunës.

## NGECJET

Në katër indikatorë të tjerë, zyra e kryetarit ka grumbulluar pikë minimale pasi që të dhënat e nevojitura nuk janë gjetur në uebfaqen zyrtare të komunës. Kjo përfshin raportin gjashtë mujor dhe raportin e kryetarit në kuvend dhe komisione (Shtylla II, Indikatori 9 dhe 10), si dhe rregullore për ngacmime seksuale (Shtylla II, indikatori 12). Përderisa, obligimi zyrtar për qasje të informata në të dhënat në të gjitha gjuhët zyrtare ka marr pikë vetëm pjesërisht, pasi që mungon përkthimi në gjuhën turke, teksa përkthimet në gjuhën serbe janë të pakta dhe mungojnë në shumë raste (shtylla II, indikatori 13).

Komuna e Mitrovicës

# Financat e komunës

9

**Në transparencën financiare, komuna e Mitrovicës është vlerësuar me pikë maksimale në tre prej gjithsej tetë indikatorëve. Për këtë çështje, ajo është vlerësuar me 9 pikë nga 16 gjithsej. Në pesë indikatorë të tjerë kjo komuna është vlerësuar pjesërisht ose negativisht.**

## TË ARRITURAT

Sa i përket boxhit publik komunal, Komuna e Mitrovicës i publikon raportet financiare dhe nuk i ka të ndara në raporte të veçanta. Përparim tjetër kjo komunë ka shënuar edhe me hapjen e komitetit për financa si dhe ftesa për pjesëmarrje qytetare.

## NGECJET

Komuna e Mitrovicës ka publikuar raportet mbi diskutimet tremujore (shtylla III, indiaktori 2) vetëm pjesërisht. Njëjtë është vlerësuar te informata mbi përgjigjet e komunës mbi kërkesat buxhetore të qytetarëve (shtylla III, indikatori 7).

Negativisht, kjo shtyllë është vlerësuar në tre indikatorë të tjerë për të cilët nuk është gjetur ndonjë informatë në uebfaqen zyrtare të komunës dhe nga përgjigjet për qasje në dokoumente publike. Këta indikatorë janë: lista e pronave të marra me qira nga komuna (shtylla III, indikatori 3), mekanizmi për regjistrimin e kërkesave buxhetore të qytetarëve (shtylla III, indikatori 4) si dhe informata mbi përgjigjet e komunës ndaj kërkesave buxhetore (shtylla III, indikatori 7).

Komuna e Mitrovicës

# Konsultimet me publikun

25

**Komuna e Mitrovicës qëndron mjaft mirë në raport me konsultimet me publikun. Nga gjithsej 16 indikatorë që janë matur në këtë shtyllë, kjo komunë është vlerësuar me pikë maksimale në 12 prej tyre. Pra, është vlerësuar me 25 pikë nga 32 gjithsej.**

## TË ARRITURAT

Për çdo drejtori dhe zyre të komunës janë të publikuara lista e përgjegjësive dhe shërbimeve që ofron Komuna e Mitrovicës. Në rast të dëgjimeve buxhetore, kur bëhet thirrja për pjesëmarrje në këto takime përcillet material shtesë sa i përket Kornizës Afatmesme Buxhetore.

Gjithashtu përparim është shënuar edhe në publikimin e informatave sa i përket pjesëmarrjes së organizatave të shoqërisë civile dhe memorandumeve të nënshkruara me këto organizata. Përveç njoftimeve në forma tradicionale, si: vendosja e njoftimeve në objektin e komunës, komuna përdor edhe rrjetet sociale për të informuar qytetarët si dhe për përfshirje të tyre në aktivitetet komunale. Janë të publikuara kontaktet e zyrtarit/res dhe zyrës për informim. Gjatë vitit 2018, komuna e Mitrovicës ka oragnizuar 8 dëgjime buxhetore dhe 1 takim publik. Raportet nga konsultimet me publikun janë të publikuara në uebfaqe.

## NGECJET

Gjatë matjes së indikatorëve është vërejtë se mungojnë informatat e hollësishme për konsolidimin e bashkësive lokale (shtylla IV, indikatori 5). Prandaj në këtë indikator, komuna e Mitrovicës është vlerësuar më vetëm një pikë. Kjo ngase procesi që ka filluar nuk ka ende një rezultat. Në tre indikatorë të tjerë të kësaj shtylle, komuna e Mitrovicës ka marr zero pikë, pasi mungon hapja e të dhënave Open Data (shtylla IV,indikatori 2), linjatelefonike pa pagesë për qytetarët (shtylla IV, indikatori 7), si dhe përkthimi i materialeve në të gjitha gjuhët zyrtare (shtylla IV, indikatori 10).

# Rekomandimet për komunën e Mitrovicës



Komuna e Mitrovicës qëndron shumë mirë sa i përket publikimit të informatave në dobi të publikut. Gjatë kohës së realizimit të këtij transparometri janë vërejtur disa fusha ku kjo komunë ngec në publikimin e tyre. Më poshtë janë tri rekomandime të cilat janë me rëndësi dhe të nevojshme në mënyrë që komuna e Mitrovicës ta rrisë tutje nivelin e transparencës.

Ftesat për Komitetin për Politikë dhe Financa, për mbledhjet e Kuvendit Komunal, dhe njoftime të tjera të tilla janë kryesisht në gjuhën shqipe dhe simbolikisht në atë serbe. Komuna do duhej të sigurojë të gjitha informatat në gjuhët zyrtare në mënyrë që qytetarët/banorët e këtij komunë të kenë qasje të barabartë në informacione.

Komuna e Mitrovicës do duhej të ofroj më shumë tranparencë financiare. Këtë mund ta bëj duke publikuar dokumente me interes për qytetarët, siç është borxhi publik i komunës, lista e pronave të marra me qira, regjistrimi apo përfshirja e kërkesave buxhetore të qytetarëve.

Një rekomandim tjetër për komunën e Mitrovicës është hapja e të dhënave Open Data. Një platformë e tillë do ta bënte të mundshme që qytetarët të jenë më të informuar dhe t'i qasen lirshëm të dhënave që përfshijnë direkt punën dhe korrektësine e kësaj komune karshi qytetarëve të saj.

Komuna e Mitrovicës do duhej të ofroj më shumë tranparencë financiare. Këtë mund ta bëj duke publikuar dokumente me interes për qytetarët, siç është borxhi publik i komunës, lista e pronave të marra me qira, regjistrimi apo përfshirja e kërkesave buxhetore të qytetarëve.



# Vitia

Komuna e Vitisë është radhitur e treta më transparente në kuadër të Transparometrit. Nga 118 pikë sa ishte maksimalja e matjes, komuna e Vitisë ka shënuar gjithsej 86 pikë. Prndryshe, kjo komunë ka nivel transperence prej 72.88% nga niveli maksimal i matjes.

Më poshtë gjeni tabelën me të dhënat për poentimin sipas shtyllave, sikurse edhe gjetjet për secilën nga shtyllat ku është bërë monitorimi dhe hulumtimi.

86 PIKË

72.88%



# Vitia


40
30
30
17
16
14
32
25
Kuvendi komunal
Zyra e kryetarit të komunës
Financat e komunës
Konsultime me Publikun

## Indikatorët për Kuvendin Komunal:

| | PIKËT |
|---|---|
| 1. A janë të publikuara materialet e nevojshme për thirrje të seancës?(procesverbalet nga mbledhja e kaluar, pikat e rendit të ditës, materiali për shqyrtim)? | 2 |
| 2. A ekziston një databazë, mekanizëm ku publikohen ose mund të sigurohet qasja në rregulloret e shqyrtuara, aprovuara dhe mënyrën e votimit? | 2 |
| 3. A janë të publikuara të dhënat biografike, kontaktet dhe kompetencat e anëtarëve të Kuvendit Komunal? | 1 |
| 4. A ka një historik të shkurtër me të dhëna kryesore në ballinë të uebfaqes që shërbejnë si letërnjoftim për Komunën? | 2 |
| 5. A mund të gjenden lehtë informacione mbi procesin e ligjbërjes, politikbërjes, dhe vendimmarrjes, në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar mbi ato procese? | 0 |
| 6. A është bërë informimi i qytetarëve për takime në kohën e caktuar sipas rregullores së Kuvendit, dhe në lokacionet e parapara: shpalljet publike në vendet më të frekuentuara, media dhe uebfaqe. | 2 |
| 7. A janë mbledhjet e komiteteve të hapura për publikun? | 2 |
| 8. A mund të gjenden lehtë kontaktet dhe të dhënat për institucionet publike të komunës (institucionet parashkollore, shtëpitë e shëndetit, etj.)? | 2 |
| 9. A janë mbajtur të gjitha seancat e rregullta të parapara me ligj (10 prej tyre)? | 2 |
| 10. A është publik organogrami i komunës? | 2 |
| 11. A monitorohen mbledhjet e KK-së, nga organizata të shoqërisë civile | 2 |
| 12. A e ka të publikuar Kuvendi planin e Punës? | 0 |
| 13. A ka KK-ja plan të veprimit për Transparencë dhe a është publik? | 2 |
| 14. A publikohen raportet për transparencë (të realizuara për komunën përkatëse nga akterë të tjerë të shoqërisë civile a tjetër)? | 0 |
| 15. A publikohen raportet nga konsultimet me publikun dhe dëgjimet për buxhet? | 0 |
| 16. A organizohen takime me organizata të shoqërisë civile? | 2 |

Komuna e Dragashit

# Kuvendi Komunal

33

Kuvendi Komunal i Dragashit, mbetet shtylla me e vlerësuar krahasuar me 3 shtyllat e tjera të vlerësimit. Nga 20 indikatorë vlerësues në këtë shtyllë, 15 prej tyre janë vlerësuar maksimalisht, 3 pjesërisht transparentë dhe 2 indikatorë janë vlerësuar jotransparent në vitin 2018. Kjo shtyllë, nga 40 pikë maksimale ka arritur në 33 pikë në total.

## TË ARRITURAT

Kuvendi Komunal i Dragashit ka bërë një përparim të madh sa i përket publikimit të agjendave dhe rendit të ditës. Janë publikuar informatat në lidhje me kontaktet (e-maili adresa dhe numri i telefonit) për anëtarët e kuvendit të komunës. Po ashtu, janë të publikuar me kohë procesverbalet e mbledhjeve të KK-së.

Mund të gjinden informacione mbi procesin e vendimmarrjes, politikbërjes dhe ligjbërjes, kryesisht të definuara në kompetencat e përshkruara në bazë të ligjit. Në uebfaqen e komunës janë të publikuara: historiku i komunës dhe të dhënat kyqe për komunën, pozita gjeografike, rrugët, aktivitetet, etj.

Kuvendi Komunal i Dragashit ka shënuar përparim në njoftimin me kohë të qytetarëve për mbledhjet dhe takimet e planifikuara, ndërkaq komitetet dhe seancat e kuvendit janë të hapura edhe për publikun. Po ashtu, KK i Dragashit ka mbajtur të gjitha seancat e rregullta të parapara për vitin 2018.

## NGECJET

Kuvendi Komunal i Dragashit si institucion më I lartë vendimmarrës ka ngecje në transparencë në 5 nga indikatorët vlerësues. Tre nga 2 indikatorët vlerësues janë vlerësuar pjesërisht transparent.  Komuna nuk ka një mekanizëm publik, i cili mund të sigurohet qasja në rregulloret e kuvendit, por e njëjta përcillet sipas procesverbaleve. Po ashtu, ka informata të mangëta sa i pëket një liste me  kontakte për institucionet publike të atilla si: objektet shkollore, QKMF, etj, derisa kontaktet e institucioneve të tjera kanë qenë të përfshira në planin e veprimit për transparencë komunale. Komuna e Dragashit nuk i publikon rregulloret komunale, derisa vendimet e kuvendit janë publikuar në baza të rregullta gjatë vitit 2018.

Mungesa e publikimit të Planit të punës së KK të komunës së Dragashit dhe qasja në draft rregullore të kuvendit janë ngecja kryesore e këtij institucioni. Për më tepër, ky organ gjatë vitit 2018 nuk e ka publikuar Planin e punës së kuvendit të komunës dhe draft rregulloret për publikun.


54

Komuna e Dragashit

# Zyra e kryetarit

15

Në këtë shtyllë, nga 15 indikatorët vlerësues, zyra e kryetarit është vlerësuar me **15 pikë** nga 30 pikë sa është maksimalja. Kjo shtyllë renditet si shtylla e dytë më transparente nga 4 shtyllat e vlerësimit të transparencës.

## TË ARRITURAT

Zyra e kryetarit të komunës në Dragash qëndron mesatarisht mirë sa i përket indikatorëve matës në këtë shtyllë. Nga 15 indikatorët vlerësues, 6 prejt tyre janë vlerësuar me transparencë maksimale. Komuna e Dragashit ka shënuar progres në publikimin e detajeve biografike dhe të dhënave kontaktuese për kryetarin, nënkryetarët, dhe drejtorët e komunës. Po ashtu ka të publikuar konkurset, të cilat janë të qasshme, por jo krahas kritereve të konkurseve të punësimit. Komuna i ka të publikuara planet zhvillimore. Kreu komunal ka raportuar në kuvend sipas ligjit. Poashtu, vendimet e kryetarit janë publike me kohë. Njëkohësisht janë publikuar informata nga takimet e kryetarit me qytetarë.

## NGECJET

Në 15 indikatorë vlerësues në këtë shtyllë, 6 prej tyre janë vlerësuar si plotësisht jo transparent, teksa 3 pjesërisht transparent.

Mungesa e zyrtarit/res/koordinatorit/res si dhe mungesa e informatave në uebfaqen e komunës për data bazën e kërkesave për qasje në dokumente publike, mungesa e publikimit të një mekanizimi përcjellës për statusin e kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, mungesa e publikimit të raporteve të cilat dalin nga zyra për integrime evropiane e komunës, mungesa e publikimit në uebfaqe e Planit të punës së Kryetarit të komunës, mungesa e publikimit në uebfaqe i raportit të punës së Kryetarit të komunës, si dhe mungesa e Rregullores komunale për ngacmimet seksuale janë indikatorët që janë vlerësuar si plotësisht jo transparent.

Raportimi i drejtorëve në Kuvend dhe komisione, mungesa e publikimit të statistikave të kërkesave për qasje në dokumente publike dhe statusit të tyre, respektimi i gjuhëve zyrtare në nivel lokal, si dhe në publikimii dokumentacionit dhe informatave në uebfaqen e komunës, mbeten indikatorët që janë vlerësuar pjesërisht transparente.

Komuna e Dragashit

# Financat e komunës

10

**Nga 16 pikë maksimale, komuna e Dragashit është vlerësuar me 10 pikë në shtyllën e transparencës financiare. Nga 8 indikatorët vlerësues në këtë shtyllë, Komuna e Dragashit ka qenë plotësisht transparente në 5 indikatorë vlerësues, teksa në 3 të tjerë plotësisht jo transparente.**

## TË ARRITURAT

Komuna e Dragashit e ka të publikuar në uebfaqen e komunës borxhin publik komunal në baza të rregullta të raportimeve tre mujore financiare. Ajo i ka diskutuar në baza të rregullta raportet tre mujore financiare në KK, sipas afateve ligjore. Ekzistojnë informata për ndryshimet buxhetore të miratuara nga KK-ja. Janë dhënë informacione të bollshme për statusin e kërkesave të qytetarëve në projeksionet buxhetore si dhe ka qasje të plotë në të dhënat për të hyrat vetjake ,të cilat pasqyrohen në raportet tre mujore financiare të komunës.

## NGECJET

Komuna e Dragashit ka qenë plotësisht jo transparente në informimin e qytetarëve për mbledhjet e KPF-së duke mos bërë njoftime për qytetarët.

Nuk e posedon asnjë mekanizëm, i cili mund të jetë publik për shënimin e regjistrimit të propozimeve të qytetarëve rreth buxhetit komunal (proceverbalet) si dhe nuk e ka publikuar listën e pronave të dhëna me qira.

Komuna e Dragashit

# Konsultimet me publikun

18

**Komuna e Dragashit, qëndron mesatarisht mirë në raport me konsultimet me publikun. Nga gjithsej 16 indikatorë që janë matur në këtë shtyllë, kjo komunë është vlerësuar me 18 pikë nga 32 sa edhe është maksimalja e vlerësimit.**

## TË ARRITURAT

Njoftimet rreth tubimeve publike kjo komunë i bën përpos me mënyrën tradicionale me shpallje në vende publike, edhe nëpërmjet rrjeteve sociale.

Kur ka dëgjime publike, ato përcillen edhe me material shtesë sa i përket Kornizës Afatmesme Buxhetore. Aktivitetet publikohen në uebfaqen e komunës në mënyrë të rregullt. Komuna organizon takime me OSHC-të, varësisht nga kërkesat e tyre. Nga këto takime, pastaj jepen njoftime publike , teksa ky veprim bëhet edhe nëpërmjet rrjeteve sociale.

## NGECJET

Konoslidimi i bashkësive lokale dhe informata të detajuara rreth këtij procesi kanë marrë vlerësim mesatar (në këtë komunëende po vijon procesi i zgjedhjeve të bashkësive lokale. Këshillat e kaluara kanë mandat të përfunduar) (shtylla IV, indikatori 5). Në këtë indikator, komuna e Dragashit është vlerësuar me vetëm një pikë, pra pjesërisht, pasi që procesi ka filluar, porse nuk ka mbaruar ende. Me këtë vlerësim del të jetë edhe përkthimi i dokumenteve në gjuhë zyrtare.

Ngecja ka edhe sa i përket hapjes së të dhënave Open Data (shtylla IV,indikatori 2), linjës telefonike pa pagesë për qytetarët (shtylla IV, indikatori 7), mungesës së një zyrtari për informim, (këtë e ushtron drejtori i administratës), mungesës së një liste të hollësishme me informata që kanë të bëjnë me kontaktet dhe objektet e tjera publike komunale. Komuna nuk i publikon raportet nga takimet me publikun në lidhje me dëgjimet për buxhetin.

# Rekomandimet për komunën e Dragashit



1. Të publikohen Rregulloret komunale
2. Të publikohen kontaktet e institucioneve publike si: shkollave, QKMF-ve, etj.
3. Të publikohet Plani i punës së KK-së
4. Të rekrutohet zyrtari për informim në komunën e Dragashit
5. Të publikohet në uebfaqen e komunës një mekanizëm përcjellës për statusin e kërkesave dhe ankesave të qytetarëve
6. Të publikohet në uebfaqen e komunës Plani i punës dhe raporti i punës së kryetarit
7. Të raportohet puna e kryetarit të komunës në KK në baza 6 mujore
8. Të hartohet Rregullorja komunale për ngacmime seksuale
9. Të raportohet nga drejtorët e drejtorive komunale puna e tyre në KK 10. Të respektohet legjislacioni i gjuhëve zyrtare në nivel lokal në publikimin e informacioneve në uebfaqen e komunës
10. Të inforomohen qytetarët për mbledhjet e KPF-së në forma tradicionale si dhe përmes uebfaqes zyrtare dhe mekanizmave të tjerë
11. Të krijohet një mekanizëm me qasje publike për shënimin dhe regjistrimin e propozimeve të qytetarëve rreth buxhetit komunal
12. Të publikohet lista e pronave të dhëna me qira
13. Të bëhet konoslidimi i bashkësive lokale dhe informata të publikohen kontaktet në uebfaqe)
14. Të bëhet hapja e të dhënave Open Data
15. Të krijohet një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët dhe
16. Të bëhet përkthimi i materialeve në të gjitha gjuhët zyrtare

Të raportohet nga drejtorët e drejtorive komunale puna e tyre në KK 10. Të respektohet legjislacioni i gjuhëve zyrtare në nivel lokal në publikimin e informacioneve në uebfaqen e komunës



# Kamenica

Komuna e Kamenicës është radhitur e shtata nga 11 komunat pjesë e Transparometrit. Ajo ka nivel të transparencës prej 62.71 %, në bazë të 59 indikatorëve të zgjedhur. Ndryshe kjo komunë, ka shënuar 74 pikë prej sa 118 sa ishte maksimalja.

Më poshtë gjeni tabelën me të dhënat për poentimin sipas shtyllave, sikurse edhe gjetjet për secilën nga shtyllat ku është bërë monitorimi dhe hulumtimi.

74 PIKË

62.71%



# Kamenica


40
26
30
10
16
14
32
24
Kuvendi komunal
Zyra e kryetarit të komunës
Financat e komunës
Konsultime me Publikun

## Indikatorët për Kuvendin Komunal:

| | PIKËT |
|---|---|
| 1. A janë të publikuara materialet e nevojshme për thirrje të seancës?(procesverbalet nga mbledhja e kaluar, pikat e rendit të ditës, materiali për shqyrtim)? | 1 |
| 2. A ekziston një databazë, mekanizëm ku publikohen ose mund të sigurohet qasja në rregulloret e shqyrtuara, aprovuara dhe mënyrën e votimit? | 1 |
| 3. A janë të publikuara të dhënat biografike, kontaktet dhe kompetencat e anëtarëve të Kuvendit Komunal? | 1 |
| 4. A ka një historik të shkurtër me të dhëna kryesore në ballinë të uebfaqes që shërbejnë si letërnjoftim për Komunën? | 2 |
| 5. A mund të gjenden lehtë informacione mbi procesin e ligjbërjes, politikbërjes, dhe vendimmarrjes, në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar mbi ato procese? | 2 |
| 6. A është bërë informimi i qytetarëve për takime në kohën e caktuar sipas rregullores së Kuvendit, dhe në lokacionet e parapara: shpalljet publike në vendet më të frekuentuara, media dhe uebfaqe. | 1 |
| 7. A janë mbledhjet e komiteteve të hapura për publikun? | 2 |
| 8. A mund të gjenden lehtë kontaktet dhe të dhënat për institucionet publike të komunës (institucionet parashkollore, shtëpitë e shëndetit, etj.)? | 0 |
| 9. A janë mbajtur të gjitha seancat e rregullta të parapara me ligj (10 prej tyre)? | 0 |
| 10. A është publik organogrami i komunës? | 2 |
| 11. A monitorohen mbledhjet e KK-së, nga organizata të shoqërisë civile | 2 |
| 12. A e ka të publikuar Kuvendi planin e Punës? | 2 |
| 13. A ka KK-ja plan të veprimit për Transparencë dhe a është publik? | 0 |
| 14. A publikohen linqe të videove pas seancave të Kuvendit? | 0 |
| 15. A ka qasje në draftrregulloret dhe planet e KK-së? | 2 |
| 16. A ka qasje në procesverbale? | 2 |
| 17. A ka qasje në rendin e ditës? | 2 |
| 18. A ka qasje në rregullore dhe vendime të KK-së? | 2 |
| 19. A janë seancat e hapura për publikun? | 2 |
| 20. A transmetohen seancat e Kuvendit drejtëpërdejtë, nëse po në çfarë platforme? | 0 |

## Zyra e kryetarit të komunës

| | |
|---|---|
| 1. A janë të publikuara detajet biografike të Kryetarit/res dhe drejtorëve/eshave (email, nr. kontaktues, biografi etj)? | 2 |
| 2. A ekzistojnë informata për çështjet që ndërlidhen me integrimet në BE dhe ndikimet e procesit në komunë? | 0 |
| 3. A janë konkurset e punësimit dhe kriteret të publikuara dhe transparente për qytetarët? | 2 |
| 4. A ka koordinator/e për qasje në dokumente zyrtare si dhe databazë me numrin e kërkesave dhe trajtimin e tyre? | 0 |
| 5. A ekziston një mekanizëm përcjellës për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve dhe statutit të kërkesave të tyre (a është publike)? | 0 |
| 6 . Si qëndron niveli i përgjigjeve për qasje në dokumente zyrtare | 0 |
| 7. A janë të publikuara Planet Zhvillimore të komunës? | 0 |
| 8. A është publik plani i punës të Kryetarit/res? | 0 |
| 9. A është publikuar raporti gjashtëmujori i punës? | 0 |
| 10. A është realizuar raporti i Kryetarit/res në Kuvend dhe komisione (raporti i punës 2 herë në vit)? | 0 |
| 11. A zhvillohen raportimet e drejtorëve/eshave në kuvend dhe komisione siç është paraparë? | 0 |
| 12. A ka komuna rregullore për ngacmime seksuale? | 0 |
| 13. A është uebfaqja e qasshme në të gjitha gjuhet zyrtare të Komunës? | 2 |
| 14. A janë vendimet e Kryetarit/res të Komunës publike dhe të qasshme për publikun? | 2 |
| 15. A ka informacione nga vizitat javore të Kryetarit/res? | 2 |

## Financat e komunës

| | |
|---|---|
| 1. A është publik borxhi publik komunal dhe borxhi i kompanive ndaj komunës? | 2 |
| 2. A janë mbajtur diskutime brenda afateve ligjore mbi shpenzimet tre-mujore në Kuvend? | 2 |
| 3. A është publike lista e pronave të lëshuara me qera nga Komuna? | 2 |
| 4. A ka një mekanizëm që shënon regjistrimin e propozimeve të qytetarëve rreth buxhetit? | 2 |
| 5. Si informohen qytetarët për pjesëmarrje në takimet e Komitetit për Financa? | 2 |
| 6. A ka qasje në informata rreth ndryshimeve buxhetore të miratuara nga KK? | 2 |
| 7. A ka informata rreth përgjigjeve që komuna i bënë ndaj kërkesave buxhetore të qytetarëve? | 0 |
| 8. A ka të dhëna mbi të hyrat vetjake të Komunës? | 2 |

## Konsultime me Publikun

| | |
|---|---|
| 1. Si është bërë dhe si është monitoruar adresimi i ankesave të qytetarëve? | 0 |
| 2. A është bërë hapja e të dhënave statistikore "Open Data"? | 0 |
| 3. A ka dhe si mund të gjinden informata rreth publikimeve të memorandumeve me OSHC-në? | 2 |
| 4. A përdor Komuna rrjete sociale në baza të rregullta? | 2 |
| 5. A është bërë konsolidimi i bashkësive lokale dhe a ka informata publike rreth tyre? | 2 |
| 6. A janë të publikuara kontaktet e zyrtarit/res dhe zyrës për informim? | 2 |
| 7. A ka një linjë direkte pa pagesë për qytetarët? | 0 |
| 8. A ekziston një listë e hollësishme të shërbimeve që institucionet ofrojnë për publikun? | 2 |
| 9. A ka materiale përcjellëse për qytetarët për dëgjimet publike dhe buxhetore? | 2 |
| 10. A përkthehen materialet në të gjitha gjuhët zyrtare? | 2 |
| 11. A bëhen njoftimet për takime publike edhe në forma tradicionale? Nëse po, në çfarë formash? | 2 |
| 12. A janë organizuar takimet publike ashtu siç janë të parapara me ligj? | 2 |
| 13. A bëhet publikimi i aktiviteteve në ballinën e uebfaqes? | 2 |
| 14. A publikohen raportet për transparencë (të realizuara për komunën përkatëse nga akterë të tjerë të shoqërisë civile a tjetër)? | 2 |
| 15. A publikohen raportet nga konsultimet me publikun dhe dëgjimet për buxhet? | 0 |
| 16. A organizohen takime me organizata të shoqërisë civile? | 2 |

Komuna e Kamenicës

# Kuvendi Komunal

**26**

Në shtyllën e KK-së, kjo komunë është vlerësuar me pikë maksimale në 11 prej gjithsej 20 indikatorëve. Ka marrë 26 pikë nga gjithsej 40 sa është pesha e kësaj shtylle.

## TË ARRITURAT

Komuna e Kamenicës ka bërë një punë të mirë në publikimin e rregulloreve dhe vendimeve, sikurse edhe publikimin e planit të punës. Seancat e kuvendit dhe mbledhjet e komiteteve janë poashtu të hapura për publikun, ndërkohë që ka pjesëmarrje të organizatave vëzhguese në këto takime.

Në uebfaqen e komunës janë të publikuar organogrami dhe historiku i komunës. Informacionet mbi procesin e ligjbërjes dhe vendimmarrjes, mund të gjinden lehtë.

## NGECJET

Në katër indikatorë të tjerë KK i Kamenicës është vlerësuar me nga një pikë. Këta indikatorë përfshijnë, publikimin e agjendës me material përcjellës (shtylla I, indikatori 1), publikimi i detjave biografike, kontakteve dhe komptencave të anëtarëve të KK-së (shtylla I, indikatori 3), informimi i qytetarëve për takimet publike (shtylla I, indikatori 6), baza e të dhënave me rregullore të shqyrtuara, aprovuara, (shtylla I, indiaktori 2).

Në pesë indikatorë të tjerë të kësaj shtylle, komuna e Kamenicës është vlerësuar negativisht, pra me zero pikë. Këto përfshijnë kontaktin dhe informacionet rreth institucioenve publike në këtë komunë (shtylla I, indikatori 8), mbajtja e të gjitha seancave të parapara me ligj (shtylla I, indikatori 9), plani i veprimit për transparencë dhe publikimi i dokumentit (shtylla I, indikatori 13), publikimi i linqeve nga mbledhjet e mbajtura (shtylla I, indikatori 14), si dhe transmetimi i drejtëpërdrejtë i seancave (shtylla I, indikatori 20).


62

Komuna
e Kamenicës

# Zyra e kryetarit

10

**Zyra e kryetarit në Kamenicë ka shënuar nivel të ulët të transparencës. Kjo shtyllë ka marrë vetëm 10 pikë nga 30 sa është vlera e saj. Nga 15 indikatorë, kjo zyrë ka marr ka pikë maksimale, teksa është vlerësuar me zero pikë për 10 të tjera.**

## TË ARRITURAT

Zyra e kryetarit në Kamenicës i ka të publikuara detajet biografike të kryetarit dhe drejtorëve. Lehtë mund të gjinden edhe informata mbi vendimet e kryetarit dhe vizitat e tij javore.

Konkurset bëhen publike në uebfaqen e komunës. Kjo uebfaqe është e qasshme nga të gjithë zyrtarët.

## NGECJET

Zyra e kryetarit në komunën e Kamenicës ka marr zero pikë në këta indikatorë: informata për çështjet që ndërlidhen me integrime në BE dhe ndikimet e procesit në komunë (shtylla II, indikatori 2); koordinator/e për qasje në dokumente publike dhe informata mbi numrin e kërkesave të aprovuara, refuzuara dhe arsyet (indikatori 4); mekanizmi përcjellës për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve dhe statusin e tyre(indikatori 5); informata mbi nivelin e përgjigjeve për qasje në dokumente publike (indikatori 6); publikimi i planeve zhvillimore të komunës (indikatori 7); publikimi i planit të punës të kryetarit (indikatori 8); publikimi i raportit gjashtëmujor të punës (indikatoi 9); raportimi i kryetarit në kuvend dhe komisione (indikatori 10); raportimet e drejtorëve/eshave në kuvend dhe komisione (indikatori (11); si dhe rregullorja për ngacmime seksuale (indikatori 12).

Komuna
e Kamenicës

# Financat e komunës

14

**Më transparente ka rezultuar të jetë shtylla e financave. Nga gjithsej tetë indikatorë, komuna e Kamenicës është vlerësuar me pikë maksimale në shtatë prej tyre. Nga 16 pikë gjithsej, kjo komunë ka marr 14 sosh.**

## TË ARRITURAT

Informata mbi borxhin publik të komunës mund të gjinden në raportet e kryetarit, të postuara në uebfaqe. Informatat mbi listën e pronave të marra me qira nga komuna si dhe për të hyrat vetjake mund të merren nëpërmjet dokumenteve zyrtare dhe nga publikimi iraporteve financiare në uebfaqen e komunës.

Përmes uebfaqes, qytetarët informohen për pjesemarrje në takimet e komitetit për politikë e financa.

## NGECJET

Shtylla e financave në komunën e Kamenicës ka marr ... pikë, pra është vlerësuar mesatraisht në dy indikatorë; mekanizmi për regjistrimin e kërkesave buxhetore të qytetarëve (shtylla III, indikatori 4)

Komuna e Kamenicës

# Konsultimet me publikun

## 24

Kjo omunë qëndron mirë në raport me kosnultimet me publikun. Nga gjithsej 16 indikatorë në këtë shtyllë, ajo ka marrë pikë maksimale për 12 prej tyre. Për katër të tjera ka marr zero pikë. Ndryshe, kjo komunë ka marr 24 pikë nga gjithsej 32 sa është pesha e indikatorëve në këtë shtyllë.

## TË ARRITURAT

Komuna e Kamenicës ka mbajtur dy takimet publike ashtu siç është e paraparë me ligj. Poashtu, materialet përcjellëse nga takimet që komuna mban dhe publikun, janë të qasshme në të gjitha gjuhët në përdorim në këtë komunë.

Komuna e Kamenicës qëndron mirë në raport me takimet me organizata të shoqërisë civile dhe publikimin e informatave rreth memorandumeve me to dhe raporteve që kanë të bëjnë me transparencën. Komuna e Kamenicës, poashtu është aktive në rrjetet sociale dhe në publikimin e aktiviteteve në ballinën e uebfaqes zyrtare të komunës. Përpos metodave digjitale, komuna e njofton publikun rreth takimeve publike në forma tradicionale, ashtu siç është e paraparë. Kontakti me zyrtarin/ren për informim është i lehtë

Komuna ka punuar në konsolidimin e bashkësive lokale dhe ka ofruar informacione rreth këtij procesi. Poashtu, në uebfaqe, mund të gjinden informata mbi shërbimet, të cilat insitucionet publike ia ofrojnë qytetarëve.

## NGECJET

Komuna e Kamenicës nuk ka informata rreth monitorimit dhe adresimit të kërkesave të qytetarëve (shtylla IV, indikatori 1), s`e ka bërë hapjen e të dhënave Open Data (indikatori 2), nuk ka linjë direkte pa pagesë për qytetarët (indikatori 7), nuk ka raport nga konsultimet me publikun dhe dëgjimet për buxhet (KAB) ( indikatori 15).

# Rekomandimet për komunën e Kamenicës



Ky raport rekomandimi, bazuar në hulumtimet e bëra për "Transparometri 2018" paraqet ngecjet, e Komunës së Kamenicës me transparencën.

1. Kjo komunë, më specifikisht zyra për informim publik ngecë jashtëzakonisht shumë në kthimin e përgjigjeve ndaj kërkesës për qasje në dokumente publike. Niveli i këtyre përgjigjeve lë shumë për të dëshiruar, ngase prej 9 dokumenteve të kërkuara nuk e kemi marrë asnjë dokument, përveç përgjigjeve me shkrim pas 16 ditësh. Prandaj, KDI-ja rekomandon që të përmirësohet kthimi i përgjigjeve, siç është paraparë në ligjin për dokumente publike, në nenin 9 dhe 10 rreth mënyrës dhe kohës se kur duhet të kthehen këto përgjigje.
2. Kuvendi Komunal i kësaj komune, nuke ka asnjë video të seancave të mbajtura. KDI-ja konsideron se incizimi i seancave do ta rriste nivelin e transparencës, duke bërë që qytetarët të jenë të informuar me atë se çka diskutohet në Kuvend. KDI-ja rekomandon që çështja e videoincizimit të seancave të Kuvendit të Kamenicës të jetë prioritet.
3. KDI-ja, gjithashtu rekomandon që të bëhet publikimi në mënyrë veçantë i disa dokumenteve të rëndësishme, si: borxhi publik, lista e pronave me qira dhe të hyrat vetjake. Kjo, ngase po të kërkohen këto dokumente në uebfaqen e komunës duhen hulumtuar në dokumente voluminoze. P.sh., nëse kërkohet lista e pronave të dhëna me qira, atëherë duhet të shikohen të gjitha vendimet e marra nga Kuvendi. Prandaj, rekomandojmë që këto dokumente të publikohen veçmas nga dokumentet e tjera, me të cilin veprim do të lehtësohej qasja në dokumente.
4. Në uebfaqen e Komunës nuk mund të gjinden kontaktet e institucioneve publike, si: institucionet parashkollore, shëndetësore etj. Prandaj, KDI-ja rekomandon që vendosen këto kontakte në uebfaqe në funksion të rritjes së transparencës. 5. Në sektorin e Kuvendit Komunal, publikimi i detajeve biografike të anëtarëve të KK-së lë shumë për të dëshiruar. KDI-ja, mendon se biografia e gjerë dhe kontaktet e anëtarëve të KK-së, duhet të jenë të qasshme për publikun. Kjo do t`i ndihmonte më shumë ata për të pasur njohuri për angzhimet e të zgjedhurve të tyre. Prandaj, KDI-ja rekomandon që të publikohen këto të dhëna të detajizuara, me të cilën gjë do të rritej transperenca komunale.

Kuvendi Komunal i kësaj komune, nuke ka asnjë video të seancave të mbajtura. KDI-ja konsideron se incizimi i seancave do ta rriste nivelin e transparencës, duke bërë që qytetarët të jenë të informuar me atë se çka diskutohet në Kuvend.



# Shtërpca

Komuna e Shtërpcës është radhitur e teta në mesin e 11 komunave që janë pjesë e transparometrit. Kjo komunë ka nivel të transparencës  prej 56.78%, ose ndryshe ka marr 67 pikë nga gjithsej 118.

Më poshtë gjeni tabelën me të dhënat për poentimin sipas shtyllave, sikurse edhe gjetjet për secilën nga shtyllat ku është bërë monitorimi dhe hulumtimi.

67 PIKË

56.78%



# Shtërpca


40
31
30
14
16
8
32
14
Kuvendi komunal
Zyra e kryetarit të komunës
Financat e komunës
Konsultime me Publikun

## Indikatorët për Kuvendin Komunal:

| | PIKËT |
|---|---|
| 1. A janë të publikuara materialet e nevojshme për thirrje të seancës?(procesverbalet nga mbledhja e kaluar, pikat e rendit të ditës, materiali për shqyrtim)? | 2 |
| 2. A ekziston një databazë, mekanizëm ku publikohen ose mund të sigurohet qasja në rregulloret e shqyrtuara, aprovuara dhe mënyrën e votimit? | 1 |
| 3. A janë të publikuara të dhënat biografike, kontaktet dhe kompetencat e anëtarëve të Kuvendit Komunal? | 0 |
| 4. A ka një historik të shkurtër me të dhëna kryesore në ballinë të uebfaqes që shërbejnë si letërnjoftim për Komunën? | 2 |
| 5. A mund të gjenden lehtë informacione mbi procesin e ligjbërjes, politikbërjes, dhe vendimmarrjes, në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar mbi ato procese? | 2 |
| 6. A është bërë informimi i qytetarëve për takime në kohën e caktuar sipas rregullores së Kuvendit, dhe në lokacionet e parapara: shpalljet publike në vendet më të frekuentuara, media dhe uebfaqe. | 2 |
| 7. A janë mbledhjet e komiteteve të hapura për publikun? | 2 |
| 8. A mund të gjenden lehtë kontaktet dhe të dhënat për institucionet publike të komunës (institucionet parashkollore, shtëpitë e shëndetit, etj.)? | 2 |
| 9. A janë mbajtur të gjitha seancat e rregullta të parapara me ligj (10 prej tyre)? | 2 |
| 10. A është publik organogrami i komunës? | 0 |
| 11. A monitorohen mbledhjet e KK-së, nga organizata të shoqërisë civile | 2 |
| 12. A e ka të publikuar Kuvendi planin e Punës? | 2 |
| 13. A ka KK-ja plan të veprimit për Transparencë dhe a është publik? | 0 |
| 14. A publikohen linqe të videove pas seancave të Kuvendit? | 2 |
| 15. A ka qasje në draftrregulloret dhe planet e KK-së? | 2 |
| 16. A ka qasje në procesverbale? | 2 |
| 17. A ka qasje në rendin e ditës? | 2 |
| 18. A ka qasje në rregullore dhe vendime të KK-së? | 2 |
| 19. A janë seancat e hapura për publikun? | 2 |
| 20. A transmetohen seancat e Kuvendit drejtëpërdejtë, nëse po në çfarë platforme? | 0 |

## Zyra e kryetarit të komunës

| | |
|---|---|
| 1. A janë të publikuara detajet biografike të Kryetarit/res dhe drejtorëve/eshave (email, nr. kontaktues, biografi etj)? | 2 |
| 2. A ekzistojnë informata për çështjet që ndërlidhen me integrimet në BE dhe ndikimet e procesit në komunë? | 0 |
| 3. A janë konkurset e punësimit dhe kriteret të publikuara dhe transparente për qytetarët? | 2 |
| 4. A ka koordinator/e për qasje në dokumente zyrtare si dhe databazë me numrin e kërkesave dhe trajtimin e tyre? | 0 |
| 5. A ekziston një mekanizëm përcjellës për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve dhe statutit të kërkesave të tyre (a është publike)? | 0 |
| 6 . Si qëndron niveli i përgjigjeve për qasje në dokumente zyrtare | 0 |
| 7. A janë të publikuara Planet Zhvillimore të komunës? | 0 |
| 8. A është publik plani i punës të Kryetarit/res? | 0 |
| 9. A është publikuar raporti gjashtëmujori i punës? | 0 |
| 10. A është realizuar raporti i Kryetarit/res në Kuvend dhe komisione (raporti i punës 2 herë në vit)? | 2 |
| 11. A zhvillohen raportimet e drejtorëve/eshave në kuvend dhe komisione siç është paraparë? | 2 |
| 12. A ka komuna rregullore për ngacmime seksuale? | 0 |
| 13. A është uebfaqja e qasshme në të gjitha gjuhet zyrtare të Komunës? | 2 |
| 14. A janë vendimet e Kryetarit/res të Komunës publike dhe të qasshme për publikun? | 2 |
| 15. A ka informacione nga vizitat javore të Kryetarit/res? | 2 |

## Financat e komunës

| | |
|---|---|
| 1. A është publik borxhi publik komunal dhe borxhi i kompanive ndaj komunës? | 2 |
| 2. A janë mbajtur diskutime brenda afateve ligjore mbi shpenzimet tre-mujore në Kuvend? | 2 |
| 3. A është publike lista e pronave të lëshuara me qera nga Komuna? | 0 |
| 4. A ka një mekanizëm që shënon regjistrimin e propozimeve të qytetarëve rreth buxhetit? | 0 |
| 5. Si informohen qytetarët për pjesëmarrje në takimet e Komitetit për Financa? | 2 |
| 6. A ka qasje në informata rreth ndryshimeve buxhetore të miratuara nga KK? | 2 |
| 7. A ka informata rreth përgjigjeve që komuna i bënë ndaj kërkesave buxhetore të qytetarëve? | 0 |
| 8. A ka të dhëna mbi të hyrat vetjake të Komunës? | 0 |

## Konsultime me Publikun

| | |
|---|---|
| 1. Si është bërë dhe si është monitoruar adresimi i ankesave të qytetarëve? | 0 |
| 2. A është bërë hapja e të dhënave statistikore "Open Data"? | 0 |
| 3. A ka dhe si mund të gjinden informata rreth publikimeve të memorandumeve me OSHC-në? | 2 |
| 4. A përdor Komuna rrjete sociale në baza të rregullta? | 2 |
| 5. A është bërë konsolidimi i bashkësive lokale dhe a ka informata publike rreth tyre? | 0 |
| 6. A janë të publikuara kontaktet e zyrtarit/res dhe zyrës për informim? | 0 |
| 7. A ka një linjë direkte pa pagesë për qytetarët? | 0 |
| 8. A ekziston një listë e hollësishme të shërbimeve që institucionet ofrojnë për publikun? | 0 |
| 9. A ka materiale përcjellëse për qytetarët për dëgjimet publike dhe buxhetore? | 0 |
| 10. A përkthehen materialet në të gjitha gjuhët zyrtare? | 2 |
| 11. A bëhen njoftimet për takime publike edhe në forma tradicionale? Nëse po, në çfarë formash? | 2 |
| 12. A janë organizuar takimet publike ashtu siç janë të parapara me ligj? | 2 |
| 13. A bëhet publikimi i aktiviteteve në ballinën e uebfaqes? | 2 |
| 14. A publikohen raportet për transparencë (të realizuara për komunën përkatëse nga akterë të tjerë të shoqërisë civile a tjetër)? | 0 |
| 15. A publikohen raportet nga konsultimet me publikun dhe dëgjimet për buxhet? | 0 |
| 16. A organizohen takime me organizata të shoqërisë civile? | 2 |

Komuna e Shtërpcës

# Kuvendi Komunal

31

Në shtyllën e Kuvendit Komunal, komuna e Shtërpcës ka shënuar pikë maksimale në 15 prej 20 indikatorëve. Në një indikator është vlerësuar me një pikë, ndërsa në katër të tjerë ka marr zero pikë. Ndryshe, në këtë shtyllë, kjo komunë ka grumbulluar gjithsej **31 pikë** nga 40 sa ishte maksimalja.

## TË ARRITURAT

Komuna e Shtërpcës është transparente në informimin në kohë të qytetarëve rreth takimeve publike si dhe bashkëngjitjen e agjhendës dhe materialeve të nevojshme. Kuvendi Komunal ka mbajtur të gjitha seancat e rregullta ashtu siç është e parashikuar me ligj. Poashtu, seancat e Kuvendit si dhe mledhjet e komiteteve janë të hapura për publikun. Aty marrin edhe organizata joqeveritare që e monitorojnë punën e këtij institucioni.Linqet nga seancat e KK-së janë të vendosura në uebfaqen e komunës. Komuna ka informacione mbi procesin e ligjbërjes, politikbërjes dhe vendimmarrjes. Plani i punës i Kuvendit ëshë i qasshëm për publikun, sikurse edhe draft rregulloret planet, procesverbalet,rregulloret dhe vendimet.

Shtërpca e ka të publikuar historikun e komunës. Në uebfaqe mund te gjinden edhe kontaktet dhe të dhënat për insitutcionet publike të komunës.

## NGECJET

Komuna e Shtërpcës kamungesë të mekanizmit, i cili regjistron bazën e të dhënave me rregullore të shqyrtuara, aprovuara dhe format e votimit. Ky indikator ka bërë që kjo komunë të vlerësohet me vetëm 1pikë. Këto informacione munt të gjinden në kuadër të procesverbaleve.

Komunës i mungon organografi, sikurse edhe plani i transparencës. Nuk janë publike të dhënat biografike dhe kontaktet e anëtarëve të Kuvendit. Poashtu, komuna e Shtërpcës nuk i transmeton drejtëpërdrejtë seancat e Kuvendit.

Komuna e Shtërpcës

# Zyra e kryetarit

14

Shtylla e zyrës së kryetarit ka shënuar pikë maksimale në 7 prej 15 indikatorëve. Në një indikator është vlerësuar me një pikë, pra pjesërisht, ndërkaq në 8 të tjerët ka marrë zero pikë. Ndryshe, në këtë shtyllë komuna e Shtërpcës ka grumbulluar **14 pikë** nga 30 sa janë gjithsej.

## TË ARRITURAT

Zyra e kryetarit në Shtërpcë është transparente sa i përket informatave me të dhëna biografike të kryetarit dhe drejtorëve/eshave. Poashtu, ka qasje në raportimin e kryetarit dhe drejtorëve/eshave në Kuvend dhe komisione. Lehtë mund të gjinden edhe informacione mbi vizitat javore të kryetarit dhe vendimet e tij.

Transparencë ka edhe në publikimin e konkurseve për punësim dhe kriteret e vendosura. Uebfaqja e komunës ka informacione në të gjitha gjuhët zyrtare të përdorura në këtë komunë.

## NGECJET

Komuna e Shtërpcës nuk e ka një rregullorë të veçantë për ngacmime seksuale. Por, ka një pjesë të veçantë, e cila e trajton këtë çështje në kuadër të kodit të sjelljes.

Komuna nuk ka informata mbi çështjet që ndërlidhen me integrime në BE dhe ndikimet e këtij procesi në komunë. Mungon poashtu informata për koordinatorin/en për qasje në dokumente zyrtare, njëlloj sikurse mungon një mekanizëm përcjellës për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve.

Komuna e Shtërpcës ka ngec në publikimin e planeve zhvillimore të punës. Nuk e ka të publikuar as planin e punës së kryetarit, si dhe raportin gjashtëmujor të punës.

Komuna e Shtërpcës

# Financat e komunës

8

Në shtyllën e financave, komuna e Shtërpcës ka shënuar pikë maksimale në 4 prej 8 indikatoëve të matur, ndërkaq në 4 të tjerët ka marrë zero pikë. Nga 16 pikë sa ishte maksimumi në këtë shtyllë, Shtërpca ka grumbulluar 8 pikë.

## TË ARRITURAT

Komuna e Graçanicës i ka publikuar borxhete saj, në kuadër të raportit financiar. Poashtu, kjo komunë i ka zhvilluar diskutimet për shpenzimet tre mujore në kuvend, brenda afatit ligjor. Komuna gjithashtu i ka publikuar ndryshimet buxhetore të miratuara nga kuvendi.

Qytetarët informohen për pjesëmarrje në takimet e komitetit për financa nëpërmjet uebfaqes zyrtare, por edhe në mënyra të tjera më të qasshme për ta.

## NGECJET

Komuna e Graçanicës nuk e ka bërë publike një listë të pronave të marra me qira nga komuna. Gjithashtu, ajo nuk ka informacione të publikuara rreth të hyrave vetjake të kësaj komune.

I mungon një mekanizëm për regjistrimin e propozimeve të qytetarëve rreth buxhetit, ndaj rrjedhimisht mungojnë edhe informatat rreth përgjigjeve të komunës ndaj këtyre kërkesave.

Komuna
e Shtërpcës

# Konsultimet me publikun

14

Në shtyllën e katërt, të konsultimeve me publikun, kjo komunë ka grumbulluar pikë maksimale, në 7 prej 16 prej indikatorëve të matur, ndërsa në 9 të tjerët ka marrë zero pikë. Nga gjithsej 32 pikë në këtë shtyllë, komuna e Shtërpcës ka grumbulluar 14 pikë.

## TË ARRITURAT

Komuna e Shtërpcës i përdor rrjetet sociale në baza të rregullta, njësoj sikurse edhe mënyra tradicionale për t`i njoftuar qytetarët rreth takimeve publike.

Ajo realizon dhe publikon informata nga takimet dhe memorandumet e nënshkruar me organizata të shoqërisë civile.

Aktivitetet e saj, komuna i publikon në uebfaqe. Të gjitha materialet e publikuara nga komuna janë të përkthyera në të gjitha gjuhët zyrtare të kësaj komune.

Komuna e Shtërpcës i ka mbajtur takimet publike ashtu siç është e paraparë me ligj, pra të paktën dy vit.

## NGECJET

Komuna e Shtërpcës nuk qëndron mirë sa i përket informatave rreth adresimit të ankesave të qytetarëve. Ajo nuk i ka të hapura të dhënat statistikore Open Data. Nuk ka informacion publik të kontaktit të zyrës apo zyrtarit/res për informim. Komuna nuk ka as linjë telefonike pa pagesë për qytetarët, sikurse as materiale përcjellëse për dëgjimet publike buxhetore apo raport nga këto dëgjime.

Komuna e Shtërpcës nuk e ka përfunduar procesin e konsolidimit të bashkësive lokale, ndaj nuk ka asnjë informacion apo kontakt për to. Mungon edhe lista e shërbimeve që i ofron institucioni për publikun.

Komuna nuk i ka të publikuara apo nuk i ka shpërndarë raportet e transparencës nga orgnaizatat joqeveritare monituruese.

# Rekomandimet për komunën e Shtërpcës



KDI-ja rekomandon komunën e Shtërpcës që ta rrisë edhe më transparencënme  publikun.
Një ndër këto rekomandime është edhe azhurnimi i uebfaqes me informacione për zhvillimet në komunë.
Gjithashtu, KDI-ja i rekomandon kësaj komune të marrë masa për rritjen e pjesëmarrjes së publikut në takimet komunale. Një masë efikase në këtë drejtim është edhe funksionalizimi i këshillave lokale si mjet për organizimin e qytetarëve.

Një ndër këto rekomandime është edhe azhurnimi i uebfaqes me informacione për zhvillimet në komunë.



# Graçanica

Komuna e Graçanicës ka dal të jetë komuna e nënta më transparente në kuadër të komunave të zgjedhura për transparometrin. Niveli i transparencës së saj është 54.24%, bazuar në 59 indikatorët e përzgjedhur. Gjithsej nga 118 pikë, kjo komunë ka shënuar 64 pikë.

Më poshte gjeni tabelën me të dhënat për poentimin sipas shtyllave, sikurse edhe gjetjet për secilën nga shtyllat ku është bërë monitorimi dhe hulumtimi.

64 PIKË

54.24%

# Graçanica


40
26
30
13
16
8
32
17
Kuvendi komunal
Zyra e kryetarit të komunës
Financat e komunës
Konsultime me Publikun

## Indikatorët për Kuvendin Komunal:

| | PIKËT |
|---|---|
| 1. A janë të publikuara materialet e nevojshme për thirrje të seancës?(procesverbalet nga mbledhja e kaluar, pikat e rendit të ditës, materiali për shqyrtim)? | 2 |
| 2. A ekziston një databazë, mekanizëm ku publikohen ose mund të sigurohet qasja në rregulloret e shqyrtuara, aprovuara dhe mënyrën e votimit? | 0 |
| 3. A janë të publikuara të dhënat biografike, kontaktet dhe kompetencat e anëtarëve të Kuvendit Komunal? | 0 |
| 4. A ka një historik të shkurtër me të dhëna kryesore në ballinë të uebfaqes që shërbejnë si letërnjoftim për Komunën? | 2 |
| 5. A mund të gjenden lehtë informacione mbi procesin e ligjbërjes, politikbërjes, dhe vendimmarrjes, në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar mbi ato procese? | 0 |
| 6. A është bërë informimi i qytetarëve për takime në kohën e caktuar sipas rregullores së Kuvendit, dhe në lokacionet e parapara: shpalljet publike në vendet më të frekuentuara, media dhe uebfaqe. | 2 |
| 7. A janë mbledhjet e komiteteve të hapura për publikun? | 2 |
| 8. A mund të gjenden lehtë kontaktet dhe të dhënat për institucionet publike të komunës (institucionet parashkollore, shtëpitë e shëndetit, etj.)? | 2 |
| 9. A janë mbajtur të gjitha seancat e rregullta të parapara me ligj (10 prej tyre)? | 2 |
| 10. A është publik organogrami i komunës? | 0 |
| 11. A monitorohen mbledhjet e KK-së, nga organizata të shoqërisë civile | 2 |
| 12. A e ka të publikuar Kuvendi planin e Punës? | 2 |
| 13. A ka KK-ja plan të veprimit për Transparencë dhe a është publik? | 0 |
| 14. A publikohen linqe të videove pas seancave të Kuvendit? | 0 |
| 15. A ka qasje në draftrregulloret dhe planet e KK-së? | 2 |
| 16. A ka qasje në procesverbale? | 2 |
| 17. A ka qasje në rendin e ditës? | 2 |
| 18. A ka qasje në rregullore dhe vendime të KK-së? | 2 |
| 19. A janë seancat e hapura për publikun? | 2 |
| 20. A transmetohen seancat e Kuvendit drejtëpërdejtë, nëse po në çfarë platforme? | 0 |

## Zyra e kryetarit të komunës

| | |
|---|---|
| 1. A janë të publikuara detajet biografike të Kryetarit/res dhe drejtorëve/eshave (email, nr. kontaktues, biografi etj)? | 0 |
| 2. A ekzistojnë informata për çështjet që ndërlidhen me integrimet në BE dhe ndikimet e procesit në komunë? | 1 |
| 3. A janë konkurset e punësimit dhe kriteret të publikuara dhe transparente për qytetarët? | 2 |
| 4. A ka koordinator/e për qasje në dokumente zyrtare si dhe databazë me numrin e kërkesave dhe trajtimin e tyre? | 0 |
| 5. A ekziston një mekanizëm përcjellës për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve dhe statutit të kërkesave të tyre (a është publike)? | 0 |
| 6 . Si qëndron niveli i përgjigjeve për qasje në dokumente zyrtare | 0 |
| 7. A janë të publikuara Planet Zhvillimore të komunës? | 0 |
| 8. A është publik plani i punës të Kryetarit/res? | 0 |
| 9. A është publikuar raporti gjashtëmujori i punës? | 0 |
| 10. A është realizuar raporti i Kryetarit/res në Kuvend dhe komisione (raporti i punës 2 herë në vit)? | 2 |
| 11. A zhvillohen raportimet e drejtorëve/eshave në kuvend dhe komisione siç është paraparë? | 2 |
| 12. A ka komuna rregullore për ngacmime seksuale? | 0 |
| 13. A është uebfaqja e qasshme në të gjitha gjuhet zyrtare të Komunës? | 2 |
| 14. A janë vendimet e Kryetarit/res të Komunës publike dhe të qasshme për publikun? | 2 |
| 15. A ka informacione nga vizitat javore të Kryetarit/res? | 2 |

## Financat e komunës

| | |
|---|---|
| 1. A është publik borxhi publik komunal dhe borxhi i kompanive ndaj komunës? | 2 |
| 2. A janë mbajtur diskutime brenda afateve ligjore mbi shpenzimet tre-mujore në Kuvend? | 2 |
| 3. A është publike lista e pronave të lëshuara me qera nga Komuna? | 0 |
| 4. A ka një mekanizëm që shënon regjistrimin e propozimeve të qytetarëve rreth buxhetit? | 0 |
| 5. Si informohen qytetarët për pjesëmarrje në takimet e Komitetit për Financa? | 2 |
| 6. A ka qasje në informata rreth ndryshimeve buxhetore të miratuara nga KK? | 2 |
| 7. A ka informata rreth përgjigjeve që komuna i bënë ndaj kërkesave buxhetore të qytetarëve? | 0 |
| 8. A ka të dhëna mbi të hyrat vetjake të Komunës? | 0 |

## Konsultime me Publikun

| | |
|---|---|
| 1. Si është bërë dhe si është monitoruar adresimi i ankesave të qytetarëve? | 0 |
| 2. A është bërë hapja e të dhënave statistikore "Open Data"? | 0 |
| 3. A ka dhe si mund të gjinden informata rreth publikimeve të memorandumeve me OSHC-në? | 2 |
| 4. A përdor Komuna rrjete sociale në baza të rregullta? | 2 |
| 5. A është bërë konsolidimi i bashkësive lokale dhe a ka informata publike rreth tyre? | 1 |
| 6. A janë të publikuara kontaktet e zyrtarit/res dhe zyrës për informim? | 2 |
| 7. A ka një linjë direkte pa pagesë për qytetarët? | 0 |
| 8. A ekziston një listë e hollësishme të shërbimeve që institucionet ofrojnë për publikun? | 2 |
| 9. A ka materiale përcjellëse për qytetarët për dëgjimet publike dhe buxhetore? | 0 |
| 10. A përkthehen materialet në të gjitha gjuhët zyrtare? | 2 |
| 11. A bëhen njoftimet për takime publike edhe në forma tradicionale? Nëse po, në çfarë formash? | 2 |
| 12. A janë organizuar takimet publike ashtu siç janë të parapara me ligj? | 2 |
| 13. A bëhet publikimi i aktiviteteve në ballinën e uebfaqes? | 2 |
| 14. A publikohen raportet për transparencë (të realizuara për komunën përkatëse nga akterë të tjerë të shoqërisë civile a tjetër)? | 0 |
| 15. A publikohen raportet nga konsultimet me publikun dhe dëgjimet për buxhet? | 0 |
| 16. A organizohen takime me organizata të shoqërisë civile? | 2 |

Komuna e Graçanicës

# Kuvendi Komunal

**26**

**Në shtyllën e Kuvendit Komunal, kjo komunë ka shënuar pikë maksimale në 13 prej 20 indikatorëve. Në 7 indikatorë të tjerë ka marr zero pikë. Nga gjithsej 40 sa ishte vlera maksimale e vlerësimit në këtë shtyllë, Graçanica ka marrë 26 pikë.**

## TË ARRITURAT

Komuna e Graçanicës ka bërë një punë të mirë në informimin me kohë të qytetarëve për takimet e planifikuara, sikurse edhe në publikim e agjendës dhe materialeve të nevojshme. Kuvendi Komunal, poashtu ka mbajtur të gjitha seancat e rregullta gjatë vitit. Ato kanë qenë të hapura për publikun, sikurse edhe takimet e komiteteve, në të cilat kanë marrë pjesë organizata monitoruese.

Komuna e ka të publikuar në uebfaqen e vet historikun e komunës dhe kontaktet e institucioneve publike të komunës.

Ajo e ka lehtësuar për qytetarët qasjen në draft rregullore, planet e kuvendit komunal, procesverbale, rendin e ditës, si dhe në rregullore e vendime.

## NGECJET

Në 7 indikatorë komuna e Graçanicës ka marrë zero pikë për shkak të mungesës së informacionit të nevojshëm. Këta indikatorë përfshijnë mungesën e organogramit të komunës (shtylla I, indikatori 10). Komuna poashtu nuk e ka të publikuar planin për transparencë (indikatori 13).

Mungojnë poashtu të dhënat biogriaike të anëtarëve të kuvendit (indikatori 3). Komuna nuk ka informacione mbi procesin e ligjbërjes, politikbërjes dhe vendmmarrjes në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar mbi ato procese (indikatori 5). Poashtu mungon një bazë e të dhënave me rregullore të shqyrtuara, të aprovuara dhe informata mbi procesin e votimit (indikatori 2).

Zero pikë kjo komunë ka marrë edhe në indikatorin 20, pasi që seancat e kuvendit nuk transmetohen drejtëpërdrejtë. Rrjedhimisht nuk ka as linqe të publikuara të mbledhjeve të kuvendit pas zhvillimit të tyre (indikatori 14).

Komuna e Graçanicës

# Zyra e kryetarit

13

**Nga 15 indikatorët në shtyllën e zyrës së kryetarit, komuna e Graçanicës ka marrë pikë maksimale në 7 prej tyre. Në një indikator ka marrë 1 pikë, ndërsa në 7 të tjerë zero pikë. Ndryshe, nga gjithsej 30 sa ishte vlera maksimale e pikëve, zyra e kryetarit në Graçanicë ka marr 13 pikë.**

## TË ARRITURAT

Zyra e kryetarit qëndron mirë me nivelin e transparencës në shpalljen e konkurseve dhe kritereve të përdorurra. Poashtu, publike jane vendimet e kryetarit si dhe informata rreth vizitave javore të kryetarit. Kjo zyrë qëndron mirë edhe në raportimin e kryetarit në kuvend dhe komisione si dhe raportimin e drejtorëve/reshave në kuvend dhe komisione.

Uebfaqja e komunës është e qasshme në të gjitha gjuhët e përdorura në këtë komunë.

## NGECJET

Kjo komunë është notuar pjesërisht te çështjet që ndërlidhen me ingrime në BE dhe ndikimin e procesit në komunë. Gjatë monitorimit këto informata janë siguruar vetëm pjesërisht.

Me zero pikë kjo komunë është vlerësuar në detajet biografike të kryetarit dhe drejtorëve/eshave, koordinatorit për qasje në dokumente zyrtare dhe informata mbi numrin e kërkesave qytetare, mekanizmit përcjellës për regjistrimin e kërsesave të qytetarëve dhe statusit të këtyre kërkesave si dhe te mungesa e informatave mbi përgjigjet e komunës ndaj këtyre kërkesave. Për më të tepër, mungojnë ose nuk janë publike planet zhvillimore të komunës, plani i punës së kryetarit, dhe raporti gjashtëmujor i punës. Sikurse shumica dërmuese e komunave të tjera, as ajo e Graçanicës nuk e ka të hartuar një rregullore për ngacmime seksuale.

Komuna e Graçanicës

# Financat e komunës

8

Nga 8 indikatorë që kanë matur tranparencën në shtyllën e financave, 4 prej tyre kanë marrë pikë maksimale dhe 4 kanë marrë zero pikë. Nga 16 sa ishte maksimalja e vlerës së indikatorëve në këtë shtyllë, Graçanica ka grumbulluar **8 pikë.**

## TË ARRITURAT

Komuna e Graçanicës qëndron mirë me publikim e borxheve të komunës, të cilat mund të gjenden te raportet financiare. Poashtu kjo komunë diskutimet për shpenzimet tre mujore i ka kryer brenda afatit ligjor. Komuna, gjithashtu ka të publikuara ndryshimet buxhetore të miratuara nga kuvendi.

Qytetarët informohen për pjesëmarrje në takimet e komitetit për financa përmes uebfaqes zyrtare por gjithashtu edhe mënyrave të tjera më të qasshme për ta.

## NGECJET

Komuna e Graçanicës nuk e ka bërë publike një listë të pronave të marra me qira nga komuna. Poashtu nuk ka informacione të publikuara rreth të hyrave vetjake .

Asaj i mungon një mekanizëm për regjistrimin e propozimeve të qytetarëve rreth buxhetit, sikurse edhe informata rreth përgjigjeve të komunës ndaj këtyre kërkesave.

Komuna e Graçanicës

# Konsultimet me publikun

17

**Nga 16 indikatorë të matur në kuadër të shtyllës konsultime me publikun, komuna e Graçanicës ka marrë pikë maksimale në 9 prej tyre. 7 prej këtyre indikatorëve kanë rezultuar negativisht, pra me zero pikë. Nga gjithsej 32 pikë sa ishin në këtë shtyllë, kjo komunë ka grumbulluar 17 pikë.**

## TË ARRITURAT

Komuna e Graçanicës qëndron mirë me përdorimin e rrjeteve sociale. Poashtu është vlerësuar pozitivisht në informata rreth takimeve me organizata të shoqërisë civile dhe informatave rreth memorandumeve me këto organizata.

Graçanica ka organizuar takimet publike siç është paraparë me ligj. Materialet zyrtare, kjo komunë i ka të qasshme në të gjitha gjuhët zyrtare të përdorura në këtë komunë.

## NGECJET

Komuna e Graçanicës ka shënuar ngecje në hapjen e të dhënave statistikore Open Data. Ajo  nuk ofron informata rreth adresimit të ankesave të qytetarëve, njëjtë sikurse nuk e një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët. Gjithashtu nuk ka informata në uebfaqen e kësaj komune mbi kontaktet e zyrtarit/res dhe zyrës për informim.

Raportet për transparencë të organizatave të tjera, kjo komunë nuk i ka publikuar në uebfaqen e saj. Nuk ka siguruar material përcjellës apo raporte nga konsultimet me publikun dhe dëgjimet për buxhet (KAB).

Komuna nuk e ka kryer procesin e konsolidimit të bashkësive lokale, ndonëse ka informata publike për mandatin e kaluar. Rrjedhimisht është vlerësuar me vetëm një pikë.

# Rekomandimet për komunën e Graçanicës

Rekomandimi kryesor i KDI-së ër komunën e Graçanicës është azhurnimi  i uebfaqes zyrtare me informata. Uebfaqja zyrtare e aprovuar nga MAPL-ja duhet të jetë e vetmja uebfaqe zyrtare në mënyrë që qytetarët të informohen në një vend dhe të mënjanohet mundësia e keqinformimit.
Komuna do duhej ta ketë një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët. Duke qenë se shumë qytetarë jetojnë në fshatra, ku ka mungesë transporti, kjo linjë do ta lehtësontë kontaktin me Komunën dhe informimin  e tyre. Një tjetër rekomandim për këtë komunë është edhe publikimi i kontaktit të zyrtarëve komunal, posaçërisht të drejtorrëve/eshave. .
Një tjetër rekomandim për komunën e Graçanicës është edhe mbulimi medial i mbledhjeve të kuvendit.

Komuna do duhej ta ketë një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët. Duke qenë se shumë qytetarë jetojnë në fshatra, ku ka mungesë transporti, kjo linjë do ta lehtësontë kontaktin me Komunën dhe informimin  e tyre



# Obiliqi

Komuna e Obiliqit ka arritur të rradhitet e dhjeta në kuadër të komunave të përzgjedhura për transparometrin. Nga 118 pikë të munduara, komuna e Obiliqit ka shënuar 63 pikë. Niveli i transparencës në përqindje është 53.39%, i matur nga 59 indikatorët e përzgjedhur.

Më poshtë është prezantuar tabela me të dhënat për poentimin sipas shtyllave. Gjithashtu janë të ndara gjetjet për secilën nga shtyllat ku është bërë monitorimi dhe hulumtimi.

63 PIKË

53.39%



# Obiliqi


40
24
30
13
16
9
32
17
Kuvendi komunal
Zyra e kryetarit të komunës
Financat e komunës
Konsultime me Publikun

## Indikatorët për Kuvendin Komunal:

| | PIKËT |
|---|---|
| 1. A janë të publikuara materialet e nevojshme për thirrje të seancës?(procesverbalet nga mbledhja e kaluar, pikat e rendit të ditës, materiali për shqyrtim)? | 1 |
| 2. A ekziston një databazë, mekanizëm ku publikohen ose mund të sigurohet qasja në rregulloret e shqyrtuara, aprovuara dhe mënyrën e votimit? | 1 |
| 3. A janë të publikuara të dhënat biografike, kontaktet dhe kompetencat e anëtarëve të Kuvendit Komunal? | 1 |
| 4. A ka një historik të shkurtër me të dhëna kryesore në ballinë të uebfaqes që shërbejnë si letërnjoftim për Komunën? | 0 |
| 5. A mund të gjenden lehtë informacione mbi procesin e ligjbërjes, politikbërjes, dhe vendimmarrjes, në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar mbi ato procese? | 2 |
| 6. A është bërë informimi i qytetarëve për takime në kohën e caktuar sipas rregullores së Kuvendit, dhe në lokacionet e parapara: shpalljet publike në vendet më të frekuentuara, media dhe uebfaqe. | 1 |
| 7. A janë mbledhjet e komiteteve të hapura për publikun? | 2 |
| 8. A mund të gjenden lehtë kontaktet dhe të dhënat për institucionet publike të komunës (institucionet parashkollore, shtëpitë e shëndetit, etj.)? | 1 |
| 9. A janë mbajtur të gjitha seancat e rregullta të parapara me ligj (10 prej tyre)? | 2 |
| 10. A është publik organogrami i komunës? | 0 |
| 11. A monitorohen mbledhjet e KK-së, nga organizata të shoqërisë civile | 2 |
| 12. A e ka të publikuar Kuvendi planin e Punës? | 2 |
| 13. A ka KK-ja plan të veprimit për Transparencë dhe a është publik? | 0 |
| 14. A publikohen linqe të videove pas seancave të Kuvendit? | 0 |
| 15. A ka qasje në draftrregulloret dhe planet e KK-së? | 2 |
| 16. A ka qasje në procesverbale? | 2 |
| 17. A ka qasje në rendin e ditës? | 2 |
| 18. A ka qasje në rregullore dhe vendime të KK-së? | 1 |
| 19. A janë seancat e hapura për publikun? | 2 |
| 20. A transmetohen seancat e Kuvendit drejtëpërdejtë, nëse po në çfarë platforme? | 0 |

## Zyra e kryetarit të komunës

| | |
|---|---|
| 1. A janë të publikuara detajet biografike të Kryetarit/res dhe drejtorëve/eshave (email, nr. kontaktues, biografi etj)? | 2 |
| 2. A ekzistojnë informata për çështjet që ndërlidhen me integrimet në BE dhe ndikimet e procesit në komunë? | 0 |
| 3. A janë konkurset e punësimit dhe kriteret të publikuara dhe transparente për qytetarët? | 2 |
| 4. A ka koordinator/e për qasje në dokumente zyrtare si dhe databazë me numrin e kërkesave dhe trajtimin e tyre? | 1 |
| 5. A ekziston një mekanizëm përcjellës për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve dhe statutit të kërkesave të tyre (a është publike)? | 0 |
| 6 . Si qëndron niveli i përgjigjeve për qasje në dokumente zyrtare | 2 |
| 7. A janë të publikuara Planet Zhvillimore të komunës? | 0 |
| 8. A është publik plani i punës të Kryetarit/res? | 0 |
| 9. A është publikuar raporti gjashtëmujori i punës? | 2 |
| 10. A është realizuar raporti i Kryetarit/res në Kuvend dhe komisione (raporti i punës 2 herë në vit)? | 0 |
| 11. A zhvillohen raportimet e drejtorëve/eshave në kuvend dhe komisione siç është paraparë? | 0 |
| 12. A ka komuna rregullore për ngacmime seksuale? | 0 |
| 13. A është uebfaqja e qasshme në të gjitha gjuhet zyrtare të Komunës? | 0 |
| 14. A janë vendimet e Kryetarit/res të Komunës publike dhe të qasshme për publikun? | 2 |
| 15. A ka informacione nga vizitat javore të Kryetarit/res? | 2 |

## Financat e komunës

| | |
|---|---|
| 1. A është publik borxhi publik komunal dhe borxhi i kompanive ndaj komunës? | 2 |
| 2. A janë mbajtur diskutime brenda afateve ligjore mbi shpenzimet tre-mujore në Kuvend? | 0 |
| 3. A është publike lista e pronave të lëshuara me qera nga Komuna? | 2 |
| 4. A ka një mekanizëm që shënon regjistrimin e propozimeve të qytetarëve rreth buxhetit? | 0 |
| 5. Si informohen qytetarët për pjesëmarrje në takimet e Komitetit për Financa? | 2 |
| 6. A ka qasje në informata rreth ndryshimeve buxhetore të miratuara nga KK? | 0 |
| 7. A ka informata rreth përgjigjeve që komuna i bënë ndaj kërkesave buxhetore të qytetarëve? | 1 |
| 8. A ka të dhëna mbi të hyrat vetjake të Komunës? | 2 |

## Konsultime me Publikun

| | |
|---|---|
| 1. Si është bërë dhe si është monitoruar adresimi i ankesave të qytetarëve? | 1 |
| 2. A është bërë hapja e të dhënave statistikore "Open Data"? | 0 |
| 3. A ka dhe si mund të gjinden informata rreth publikimeve të memorandumeve me OSHC-në? | 2 |
| 4. A përdor Komuna rrjete sociale në baza të rregullta? | 0 |
| 5. A është bërë konsolidimi i bashkësive lokale dhe a ka informata publike rreth tyre? | 1 |
| 6. A janë të publikuara kontaktet e zyrtarit/res dhe zyrës për informim? | 2 |
| 7. A ka një linjë direkte pa pagesë për qytetarët? | 0 |
| 8. A ekziston një listë e hollësishme të shërbimeve që institucionet ofrojnë për publikun? | 2 |
| 9. A ka materiale përcjellëse për qytetarët për dëgjimet publike dhe buxhetore? | 2 |
| 10. A përkthehen materialet në të gjitha gjuhët zyrtare? | 1 |
| 11. A bëhen njoftimet për takime publike edhe në forma tradicionale? Nëse po, në çfarë formash? | 2 |
| 12. A janë organizuar takimet publike ashtu siç janë të parapara me ligj? | 0 |
| 13. A bëhet publikimi i aktiviteteve në ballinën e uebfaqes? | 2 |
| 14. A publikohen raportet për transparencë (të realizuara për komunën përkatëse nga akterë të tjerë të shoqërisë civile a tjetër)? | 0 |
| 15. A publikohen raportet nga konsultimet me publikun dhe dëgjimet për buxhet? | 0 |
| 16. A organizohen takime me organizata të shoqërisë civile? | 2 |

Komuna e Obiliqit

# Kuvendi Komunal

**24**

Kuvendi Komunal i Obiliqit është vlerësuar me pikë maksimale në 9 prej gjithsej 20 indikatorëve që janë matur. Pra, nga gjithsej 40 pikë sa ka qenë vlera maksimale e këtyre indikatorëve, shtylla e kuvendit komunal të Obiliqit ka shënuar pikë maksimale në 24 nga to.

## TË ARRITURAT

Kuvendi Komunal i Obiliqit ka bërë një përparim në gjetjen më të lehtë të informacioneve mbi proceset e vendimmarrjes, politikbërjes dhe ligjbërjes.

Ky organ e ka të publikuar planin e punës dhe komiteteve. Seancat e Kuvendit Komunal janë të hapura për publikun dhe gjithnjë ka prezencë të OJQ-ve monitoruese.

Kuvendi komunal i Obiliqit ka mbajtur 10 seanca të rregullta të parapara për vitin 2018.

## NGECJET

Kuvendi Komunal i Obiliqit është vlerësuar me nga një pikë, d.m.th. pjesërisht tek gjashtë indikatorë të tjerë. Këta gjashtë indikatorë kanë të bëjnë me publikimin e plotë të agjendave të takimeve (shtylla 1, indikatori 1), pastaj me mekanizmin që siguron qasje në rregulloret e shqyrtuara, të aprovuara si dhe mënyrën e votimit (shtylla I, indikatori 2), publikimi i të dhënave biografike të anëtarëve të Kuvendit Komunal (shtylla 1, indikatori 3). Ka ngecje në publikimin e të gjitha thirrjeve për mbledhje të KK-së(shtylla 1, indikatori 6). Në uebfaqen e komunës mund të gjinden pjesërisht kontaktet për institucionet publike (shtylla 1, indikatori 8) si dhe rregulloret e vendimet e KK-së (shtylla 1, indikatori 18).

Me pikë nuk janë vlerësuar në pesë indikatorë, për mungesë të një historiku me të dhënat për qytetitn (shtylla 1, indikatori 4), të publikimeve të organogramit (shtylla 1, indikatori 10), të planit të transparencës (shtylla 1, indikatori 13), linqeve të videove të mbledhjeve të kuvendeve komunale (shtylla 1, indikatori 14) si dhe në transmetimin e drejtëpërdrejtë të seancave të Kuvendit Komunal (shtylla 1, indikatori 20).

Komuna e Obiliqit

# Zyra e kryetarit

13

Nga 15 indikatorë, zyra e kryetarit në komunën e Obiliqit ka shënuar pikë maksimale në 7 prej tyre. Më saktësisht është vlerësuar me **13 pikë** nga 30 gjithsej në këtë shtyllë.

## TË ARRITURAT

Përparim ka në publikimin e detajeve biografike dhe të dhënave kontaktuese për kryetarin, drejtorët dhe drejtoreshat e komunës. Po ashtu, kriteret e punësimit, dhe forma e aplikimit janë të publikuara me kohë dhe të detajuara. Komuna e Obiliqit u është përgjigjur të gjitha kërkesave për qasje në dokumente zyrtare brenda afatit ligjor. Në uebfaqe janë të publikuara: raporti gjashtëmujor i punës, vendimet e kryetarit të Komunës që janë të qasshme për publikun, e njëjta vlenë edhe për informacionet rreth vizitave javore të kryetarit të cilat postohen në uebfaqe dhe në rrjete sociale.

## NGECJET

Në tetë indikatorë të tjerë zyra e kryetarit të Komunës së Obiliqit është vlerësuar me pikë minimale. Këta indikatorë kanë të bëjnë me mungesën e informacioneve rreth zyrës për Integrime Evropiane (shtylla 2, indikatori 2), në publikimin e kërkesave të qytetarëve (shtylla 2, indikatori 5), planeve zhvillimore të komunës (shtylla 2, indikatori 7), planin e punës së kryetarit (shtylla 2, indikatori 8), raportit të kryetarit në Kuvend (shtylla 2, indikatori 10), raporteve të drejtorëve në kuvend dhe komisione (shtylla 2, indikatori 11), hartimin e një rregullore për ngacmimseksual (shtylla 2 indikatori 12) si dhe në qasjen e uebfaqes në gjuhët zyrtare të Komunës (shtylla 2, indikatori 13).

Komuna e Obiliqit

# Financat e komunës

9

**Në transparencën financiare, komuna e Obiliqit është vlerësuar me pikë maksimale në tre prej gjithsej tetë indikatorëve. Kësisoj ka marrë 9 pikë nga 16 gjithsej. Në pesë indikatorë të tjerë, kjo komunë është vlerësuar pjesërisht ose negativisht.**

## TË ARRITURAT

Komuna e Obiliqit e ka të publikuar listën e pronave të marra me qira. Të dhënat mbi të hyrat vetjake mund të gjinden lehtë. Gjithashtu nuk mungon informimi i qytetarëve me kohë për takimet e komitetit për financa. Për këta indikatorë është vlerësuar me pikë maksimale.

## NGECJET

Komuna e Obiliqit e ka të qasshme pjesërisht borxhin publik komunal (shtylla III, indikatori 1). Pjesërisht është vlerësuar edhe në indikatorin për regjistrimin e propozimeve të qytetarëve për buxhet (shtylla III, indikatori 4). Me pikë minimale është vlerësuar në mbajtjen e diskutimeve për shpenzimet tre mujore në Kuvend (shtylla III, indikatori 2), në informata për ndryshimet buxhetore të miratuara nga KK (shtylla III, indikatori 6) si dhe rreth informatave mbi përgjigjet e komunës ndaj kërkesave buxhetore të qytetarëve (shtylla III, indikatori 7).

Komuna e Obiliqit

# Konsultimet me publikun

17

Komuna e Obiliqit, nga gjithsej 16 indikatorë që janë matur në këtë shtyllë është vlerësuar me pikë maksimale në 8 prej tyre. Ndryshe është vlerësuar me **17 pikë** nga 32 gjithsej.

## TË ARRITURAT

Komuna ka arritur që çdo kërkesë të qytetarëve t`ua adresojë drejtorive përkatëse për shqyrtim. Gjithashtu përparim ka shënuar edhe në publikimin e informacioneve sa i përket pjesëmarrjes së organizatave të shoqërisë civile dhe memorandumeve të nënshkruara më to. Përveç njoftimeve në uebfaqe, komuna i publikon njoftimet edhe në forma tradicionale, si vendosja e njoftimeve në objektin e komunës, apo në vende të frekuentuara. Janë të publikuara kontaktet e zyrtarit/res dhe zyrës për informim. Komuna ka një listë të hollësishme të shërbimeve që ofrojnë institucionet për publikun.

## NGECJET

Konsolidimi i bashkësive lokale dhe informata të detajuara rreth këtij procesi (shtylla IV, indikatori 5) si dhe përkthimi i materialeve në të gjitha gjuhët zyrtare (shtylla IV, indikatori 10) janë vlerësuar me një pikë, d.m.th. pjesërisht pasi që jo të gjitha materialet përkthehen në gjuhën serbe.

Gjithashtu, komuna e Obiliqit ka marr zero pikë për mungesë të hapjes së të dhënave Open Data (shtylla IV,indikatori 2), përdorimin e rrjeteve sociale (shtylla IV, indikatori 4), një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët (shtylla IV, indikatori 7), mungesa e raporteve nga dëgjimet publike (shtylla IV, indikatori 12), mungesa e publikimit të raporteve të transparencës nga shoqëria civile (shtylla IV, indikatori 14) si dhe mungesa e raporteve nga dëgjimet për buxhet (shtylla IV, indikatori 15).

# Rekomandimet për komunën e Obiliqit



Në komunën e Obiliqit vërehet nevoja për një ristrukturim të uebfaqes dhe mënyrës së vendosjes së informacioneve në të. Më poshtë kemi përmbledhur disa rekomandime, të domosdoshme, në përpjekje për të rritur transparencën e Komunës karshi qytetarëve të saj.

Emërtimi i vendimeve të publikuara- vendimet janë të publikuara vetëm me numra, pa emërtime të veçanta dhe kjo e bënë të vështirë gjetjen dhe qasjen për qytetarët në këto vendime.

Rritje e publikimit të informacioneve që kanë të bëjnë me punën e Kuvendit Komunal në përgjithësi. Publikimi me kohë i thirrjeve dhe agjendave të takimeve, plotësimi i të dhënave për anëtarët e Kuvendit të kësaj komune si dhe mungesa e një platforme për publikimin e linqeve të videove të mbledhjeve të KK-së.

Publikimi i materialeve të përkthyera në gjuhët zyrtare të Komunës, duke përfshirë komunitetet pakicë të Obiliqit është i pashmangshëm dhe i domosdoshëm.

Publikimi i materialeve të përkthyera në gjuhët zyrtare të Komunës, duke përfshirë komunitetet pakicë të Obiliqit është i pashmangshëm dhe i domosdoshëm.



# Mamusha

Komuna e Mamushës është e fundit dhe më pak transparente në kuadër të komunave të zgjedhura për transparometrin. Niveli i transparencës është 27.12 %, bazuar në 59 indikatorët e përzgjedhur.  Ndryshe, komuna e Mamushës ka marr 32 pikë nga 118 sa ishte maksimalja.

Më poshtë gjeni tabelën me të dhënat për poentimin sipas shtyllave, sikurse edhe gjetjet për secilën nga shtyllat ku është bërë monitorimi dhe hulumtimi.




27.12%



# Mamusha


40
13
30
6
16
0
32
13
Kuvendi komunal
Zyra e kryetarit të komunës
Financat e komunës
Konsultime me Publikun

## Indikatorët për Kuvendin Komunal:

| | PIKËT |
|---|---|
| 1. A janë të publikuara materialet e nevojshme për thirrje të seancës?(procesverbalet nga mbledhja e kaluar, pikat e rendit të ditës, materiali për shqyrtim)? | 0 |
| 2. A ekziston një databazë, mekanizëm ku publikohen ose mund të sigurohet qasja në rregulloret e shqyrtuara, aprovuara dhe mënyrën e votimit? | 0 |
| 3. A janë të publikuara të dhënat biografike, kontaktet dhe kompetencat e anëtarëve të Kuvendit Komunal? | 1 |
| 4. A ka një historik të shkurtër me të dhëna kryesore në ballinë të uebfaqes që shërbejnë si letërnjoftim për Komunën? | 0 |
| 5. A mund të gjenden lehtë informacione mbi procesin e ligjbërjes, politikbërjes, dhe vendimmarrjes, në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar mbi ato procese? | 0 |
| 6. A është bërë informimi i qytetarëve për takime në kohën e caktuar sipas rregullores së Kuvendit, dhe në lokacionet e parapara: shpalljet publike në vendet më të frekuentuara, media dhe uebfaqe. | 0 |
| 7. A janë mbledhjet e komiteteve të hapura për publikun? | 2 |
| 8. A mund të gjenden lehtë kontaktet dhe të dhënat për institucionet publike të komunës (institucionet parashkollore, shtëpitë e shëndetit, etj.)? | 0 |
| 9. A janë mbajtur të gjitha seancat e rregullta të parapara me ligj (10 prej tyre)? | 2 |
| 10. A është publik organogrami i komunës? | 0 |
| 11. A monitorohen mbledhjet e KK-së, nga organizata të shoqërisë civile | 2 |
| 12. A e ka të publikuar Kuvendi planin e Punës? | 0 |
| 13. A ka KK-ja plan të veprimit për Transparencë dhe a është publik? | 0 |
| 14. A publikohen linqe të videove pas seancave të Kuvendit? | 0 |
| 15. A ka qasje në draftrregulloret dhe planet e KK-së? | 0 |
| 16. A ka qasje në procesverbale? | 1 |
| 17. A ka qasje në rendin e ditës? | 1 |
| 18. A ka qasje në rregullore dhe vendime të KK-së? | 0 |
| 19. A janë seancat e hapura për publikun? | 2 |
| 20. A transmetohen seancat e Kuvendit drejtëpërdejtë, nëse po në çfarë platforme? | 2 |

## Zyra e kryetarit të komunës

| | |
|---|---|
| 1. A janë të publikuara detajet biografike të Kryetarit/res dhe drejtorëve/eshave (email, nr. kontaktues, biografi etj)? | 1 |
| 2. A ekzistojnë informata për çështjet që ndërlidhen me integrimet në BE dhe ndikimet e procesit në komunë? | 0 |
| 3. A janë konkurset e punësimit dhe kriteret të publikuara dhe transparente për qytetarët? | 0 |
| 4. A ka koordinator/e për qasje në dokumente zyrtare si dhe databazë me numrin e kërkesave dhe trajtimin e tyre? | 1 |
| 5. A ekziston një mekanizëm përcjellës për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve dhe statutit të kërkesave të tyre (a është publike)? | 0 |
| 6 . Si qëndron niveli i përgjigjeve për qasje në dokumente zyrtare | 2 |
| 7. A janë të publikuara Planet Zhvillimore të komunës? | 0 |
| 8. A është publik plani i punës të Kryetarit/res? | 0 |
| 9. A është publikuar raporti gjashtëmujori i punës? | 0 |
| 10. A është realizuar raporti i Kryetarit/res në Kuvend dhe komisione (raporti i punës 2 herë në vit)? | 0 |
| 11. A zhvillohen raportimet e drejtorëve/eshave në kuvend dhe komisione siç është paraparë? | 0 |
| 12. A ka komuna rregullore për ngacmime seksuale? | 0 |
| 13. A është uebfaqja e qasshme në të gjitha gjuhet zyrtare të Komunës? | 0 |
| 14. A janë vendimet e Kryetarit/res të Komunës publike dhe të qasshme për publikun? | 0 |
| 15. A ka informacione nga vizitat javore të Kryetarit/res? | 2 |

## Financat e komunës

| | |
|---|---|
| 1. A është publik borxhi publik komunal dhe borxhi i kompanive ndaj komunës? | 0 |
| 2. A janë mbajtur diskutime brenda afateve ligjore mbi shpenzimet tre-mujore në Kuvend? | 0 |
| 3. A është publike lista e pronave të lëshuara me qera nga Komuna? | 0 |
| 4. A ka një mekanizëm që shënon regjistrimin e propozimeve të qytetarëve rreth buxhetit? | 0 |
| 5. Si informohen qytetarët për pjesëmarrje në takimet e Komitetit për Financa? | 0 |
| 6. A ka qasje në informata rreth ndryshimeve buxhetore të miratuara nga KK? | 0 |
| 7. A ka informata rreth përgjigjeve që komuna i bënë ndaj kërkesave buxhetore të qytetarëve? | 0 |
| 8. A ka të dhëna mbi të hyrat vetjake të Komunës? | 0 |

## Konsultime me Publikun

| | |
|---|---|
| 1. Si është bërë dhe si është monitoruar adresimi i ankesave të qytetarëve? | 2 |
| 2. A është bërë hapja e të dhënave statistikore "Open Data"? | 0 |
| 3. A ka dhe si mund të gjinden informata rreth publikimeve të memorandumeve me OSHC-në? | 1 |
| 4. A përdor Komuna rrjete sociale në baza të rregullta? | 2 |
| 5. A është bërë konsolidimi i bashkësive lokale dhe a ka informata publike rreth tyre? | 0 |
| 6. A janë të publikuara kontaktet e zyrtarit/res dhe zyrës për informim? | 0 |
| 7. A ka një linjë direkte pa pagesë për qytetarët? | 0 |
| 8. A ekziston një listë e hollësishme të shërbimeve që institucionet ofrojnë për publikun? | 0 |
| 9. A ka materiale përcjellëse për qytetarët për dëgjimet publike dhe buxhetore? | 2 |
| 10. A përkthehen materialet në të gjitha gjuhët zyrtare? | 0 |
| 11. A bëhen njoftimet për takime publike edhe në forma tradicionale? Nëse po, në çfarë formash? | 2 |
| 12. A janë organizuar takimet publike ashtu siç janë të parapara me ligj? | 0 |
| 13. A bëhet publikimi i aktiviteteve në ballinën e uebfaqes? | 0 |
| 14. A publikohen raportet për transparencë (të realizuara për komunën përkatëse nga akterë të tjerë të shoqërisë civile a tjetër)? | 2 |
| 15. A publikohen raportet nga konsultimet me publikun dhe dëgjimet për buxhet? | 0 |
| 16. A organizohen takime me organizata të shoqërisë civile? | 2 |

Komuna
e Mamushës

# Kuvendi Komunal

13

Kuvendi i Komunës së Mamushës, nga 20 indikatorë vlerësues në këtë shtyllë, vetëm në njërin prej tyre është vlerësuar maksimalisht, ndërsa në 19 të tjeräështë vlerësuar me transparencë minimale për vitin 2018. Në këtë shtyllë, nga 40 pikë maksimale, kjo komunë ka grumbulluar **13 pikë** në total.

## TË ARRITURAT

Në Kuvendin e Komunës së Mamushës, seancat përcillen dhe monitorohen nga organizata të shoqërisë civile. Të njëjtat transmetohen dhe monitorohen gjithashtu me teleprezencë nga MAPL-ja.

## NGECJET

Kuvendi i Komunës së Mamushës si insitucion më i lartë vendimmarrës ka ngecje të transparencës në pothuajse të gjithë indikatorët e vlerësuar nga 20 sosh. Janë 18 indikatorë që kanë ngecje të thekëuar në këtë komunë: pasivitetit i uebfaqes, mosazhurnimi i saj me informacione, apo dokumente. mospublikimi i agjendës paraprake bashkë me materialet përcjellëse, të njëjtat u dërgohen organizatave përmes emailit me kërkesë të tyre. Nuk ekziston një datatbazë, mekanizëm ku publikohen ose mund të sigurohet qasja në rregulloret e shqyrtuara, aprovuara , nëmënyrën e votimit. Nuk ka asnjë informatë rreth biografive dhe kontakteve të anëtarëve të KK-së. Komuna nuk ka një historik të shkurtër rreth të dhënve për komunën në uebfaqe. Nuk ka informata mbi procesin e ligjbërjes, politibërjes dhe vendimmarrjes në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar mbi këto procese. Në uebfaqe, gjithashtu mungojnë informata për takimet e komunës me qytetarë, sikikurse nuk ka asnjë informacion të detajuar për institucionet e tjera publike të komunës. Seancat janë organizuar sipas ligjit, por nuk ka asnjë informatë për to, përveç teleprezencës së MAPL-së.

Komuna e Mamushës nuk e ka të publikuar organogramin, planin e punës së kuvendit. Poashtu, nuk ka plan të veprimit për transparencë. Rrjedhimisht,qytetarët nuk kanë qasje në draft rregulloret e shqyrtuara në kuvend, rregulloret, apo procesverbalet e mbledhjeve. Të njejtat nuk janë të postuara në uebfaqe, ndaj të interesuarit mund të qasen në to vetëm nëpërmjet kërkesës për qasje në dokumente publike.

Komuna
e Mamushës

# Zyra e kryetarit

6

Në këtë shtyllë, nga 15 indikatorët vlerësues, zyra e kryetarit është vlerësuar me **6 pikë** nga 30 pikë maksimale.

## TË ARRITURAT

Zyra e kryetarit e komunës së Mamushës nuk qëndron mirë sa i përket indikatorëve matës në këtë shtyllë. Nga 15 indikatorët vlerësues, vetëm dy prejt tyre janë vlerësuar pjesërisht transparent: ai i paraqitjes së biografisë së shkurtër të kryetarit, kontakteve të nënkryetarit, nënkryetares dhe dy drejtorive sikurse edhe lajmeve të shkrutra nga takimet e qytetarëve me kryetarin, të plasuara kryesisht në rrjetin social Facebook.

## NGECJET

Në 15 indikatorë vlerësues në këtë shtyllë, 13 prej tyre janë vlerësuar plotësisht jo transparent.

Komuna e Mamushës, e ka një zyrtar për integrime evropiane, por për publikun nuk ka asnjë informatë në lidhje me raportet e kësaj zyre dhe informata që lidhen me integrimet evropiane. Gjithashtu nuk ka asnjë kontakttë zyrtarit, sikurse nuk e ka të publikuar asnjë konkurs. Mamusha nuk e ka një databazë e cila regjistron numrin e kërkesave dhe dokumenteve përcjellëse. kërkesave për qasje në dokumente publike, kjo komunë u përgjijget me kohë, porse nuk ka informata për publikun në lidhje me këto kërkesa. Pastaj, mungojnë planet zhvillimore komunale në uebfaqe. Nuk është publikuar raportii punës së kryetarit. Nëvitin 2018 kryetari nuk ka raportuar asnjëherë në Kuvend. Kjo komunë nuk e ka ndonjë rregullore të hartuar për ngacmimet seksuale. Uebfaqja është tërësisht pasive dhe jo e pasur me dokumente. Mungojnë tërësisht ato të përkthyera në gjuhët zyrtare.

Komuna
e Mamushës

# Financat e komunës

0

**Nga 16 pikë maksimale, komuna e Mamushës është vlerësuar me vetëm 0 pikë në shtyllën e transparencës financiare. Nga 8 indikatorët vlerësues në këtë shtyllë, Komuna e Mamushës ka qenë plotësisht jo transparente në të gjithë indikatorët vlerësues.**

## TË ARRITURAT

Komuna e Mamushës, në këtë shtyllë nuk ka asnjë përparim sa i përket tranparencës buxhetore.

## NGECJET

Komuna e Mamushës  ka qenë në plotni jo transparente në informimin rreth borxhit publik komunal, borxhit të kompanive(raportet e tilla pasyrohen në raportet vjetore financiare të cilat nuk janë publike në faqe të komunës, por që me kërkesë, qytetarët qasjen e kanë gjithmonë në ato informata). Kuvendi i Mamushës, më 2018, nuk ka mbajtur asnjë dëgjim publik, siç e parasheh Ligji. Kjo komunë e ka vetëm një pronë me qira. Ajo është dhënë në shfrytëzim sipas procedurave ligjore me miratim të kuvendit. Por, për të nuk është publikuar asnjë informacion në uebfaqen e komunës. Mamusha nuk ka ndonjë mekanizëm me të cilin  regjistrohen kërkesat e qytetarëve për buxhet (deri më tani, nuk ka patur të interesuar, bazuar në intevistën e zhvilluar me zyrtarë për buxhet dhe financa). Ka mungesë të njoftimeve në  uebfaqe për mbledhjet e KPF-së. Gjithashtu,  nuk ka informata publike rreth ndryshimeve buxhetore, shkaku i mosazhurnimit të uebfaqes.

Mungojnë të dhënat për të hyrat vetjake. Me kërkesë  të publikut, ato informata mund të vihen në dispozicion me kërkesë pë qasje në dokumente publike.

# Konsultimet me publikun

13

**Komuna e Mamushës, qëndron relativisht mirë në raport me konsultimet me publikun. Nga gjithsej 16 indikatorë që janë matur në këtë shtyllë, kjo komunë është vlerësuar me 13 pikë nga 32 pikë maksimale.**

## TË ARRITURAT

Komuna e përdor rrjetin social Facebook për të plasuar informacione. Për takimet me OSHC-të, komuna njofton nëpërmjet FB-së. Adresimin e ankesave qytetarët e bëjnë në zyrat e pritjes në komunë (më 2018 ka patur aneksa rreth vërshimeve që kanë dëmtuar serrat e fermerëve), memorandumet e mirëkuptimit me OSHC-të, zakonisht publikohen si lajme në FB. Kurse njoftimet rreth tubimeve publike kjo komunë i bën nëpërmjet tabelës së shpalljeve, FB-së, apo në hapësira të frekuentuara publike.

## NGECJET

Nga të gjeturat, del se uebfaqja e e komunës është tërësisht pasive. Ajo nuk posedon materiale dhe informata për qytetarët. Nuk ka asnjë dokument të publikuar, por as të përkthyer në gjuhë zyrtare, siç nuk ka as ndonjë databazë Open Data. Gjithashtu i mungon edhe një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët. Mungojnë të dhënat për publikun në lidhje më objektet publike të komunës. Në ballinën e uebfaqes nuk publikohen njoftimet nga aktivitetet ditore të komunës. Poashtu as raportet e ndryshme nga OSHC-të.

# Rekomandimet për komunën e Mamushës



1. Rifunksionalizimi i uebfaqes së komunës
2. Të raportohet nga kryetari puna e tij në Kuvend
3. Të raportohet nga drejtorëë e drejtorive puna e tyre në Kuvend
4. Të pasurohet uebfaqja me materiale e dokumente
5. Rifreskimi me lajme ditore nga aktivitetet e komunës
6. Publikimi i të dhënave biografike për gjithë zyrtarët dhe dikasteret
7. Të publikohet në uebfaqen e komunës mekanizimi përcjellës për statusin e kërkesave dhe ankesave të qytetarëve
8. Të publikohen të gjitha dokumentet buxhetore bashkë me raportet periodike
9. Të mbahen qytetarët të njoftuar për të gjitha takimet publike të komunës përmes uebfaqes komunale
10. Të publikohet në uebfaqen e komunës Plani i punës dhe raporti i punës së kryetarit
11. Të raportohet puna e kryetarit të komunës në Kuvend Komunal në baza 6 mujore
12. Të hartohet Rregullorja komunale për ngacmimet seksuale
13. Të raportohet nga drejtorët e drejtorive komunale puna e tyre në Kuvendin Komunal
14. Të respektohet legjislacioni i gjuhëve zyrtare në nivel lokal për publikimin e informacioneve në uebfaqen e komunës
15. Të krijohet një mekanizëm me qasje publike për shënimin dhe regjistrimin e propozimeve të qytetarëve rreth buxhetit komunal
16. Të publikohet lista e pronave të dhëna me qira
17. Të bëhet hapja e të dhënave Open Data
18. Të krijohet një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët, dhe
19. Të bëhet përkthimi i materialeve në të gjitha gjuhët zyrtare

Të raportohet nga drejtorët e drejtorive komunale puna e tyre në Kuvendin Komunal

# REKOMANDIMET

Një numër i ngecjeve të evidentuara nëpër komuna dalin të jenë të ngjashme. Rrjedhimisht, ato ulin nivelin e përgjithshëm të transparencës në institucionet e qeverisjes lokale në Kosovë. Gjatë hulumtimit, janë identifikuar ngecjet më të shpeshta dhe të cilat janë të domosdoshme për t`u adresuar në mënyrë që komunat të jenë sa më transparente karshi publikut. Më poshtë, kemi listuar disa rekomandime që kanë dalë nga këto të gjetura:

## > Publikimi i dokumenteve të veçanta me emërtime adekuate

Komunat janë të obliguara sipas udhëzimit administrativ për transparencë[9] në komuna si dhe udhëzimit për uebfaqet e insitucioneve publike[10] që të sigurojnë arritjen sa më të lehtë deri te informacioni në uebfaqen zyrtare. Shpeshëherë mosemërtimi i duhur, ose publikimi i dokumenteve të veçanta e problematizon arritjen deri te informacioni në më mënyrën lehtë. Kësisoj rekomandohen komunat, ashtu siç parashihet udhëzimin administrativ t`i publikojnë dokumentet publike, duke vendosur për secilin nga një vegëz të veçantë për ta lehtësuar qajsne e qytetarëve.

## > Krijimi i mekanizmave efikas për dokumentimin e kërkesave të qytetarëve dhe statusit të këtyre kërkesave. Kjo rrejdhimisht kontribuon edhe në ngritjen e llogaridhënies qytetare

Mekanizma digjital publik për dokumentim të kërkesave të qytetarëve dhe statusit të tyre do ta lehtësonte procesin e trajtimit dhe adresimit të nevojave dhe kërkesave qytetare. Komunat do të duhej të ndërrmarin hapa drejt funksionalizimit të këtyre mekanizmeve përbrenda kapaciteteve të tyre institucionale. Në të njëjtën kohë do të lehtësohej puna e zyrtarëve për monitorimin e këtij procesi. Kjo do ta bënte më të lehtë qasjen në informacione tëpalëve të interesuara. E gjithë kjo kontribuonte në ngritjen e nivelit të llogaridhënies së këtyre institucione.

## > Hapja e të dhënave Open Data

Digjitalizimi i të dhënave dhe informacioneve për publikun do ta lehtësonte punën e komunave në trajtimin e numrit të madh të kërkesave të qytetarëve, qofshin ato për qasje në dokumente publike apo për nevoja personale. Kësisoj do të lehtësohej dhe shpejtohej arritja deri te informacioni për qytetarët dhe palët e interesuara.

## > Hartimi i rregulloreve për ngacmime seksuale

KDI-ja inkurajon fuqishëm komunat që të ndërmarrin hapa drejt hartimit dhe aprovimit të rregulloreve për ngacmime seksuale. Me to do të përkufizohen dhe ndalohen të gjitha format e diskriminimit në baza gjinore si dhe kanosjet.

## > Përdorimi i të gjitha gjuhëve zyrtare në dokumentet publike dhe komunikimit me qytetarë

Fuqishëm inkurajohen institucionet komunale që ta përfillin ligjin për përdorimin e gjuhëve zyrtare[11] . Për më tepër, KDI beson se qasja në gjuhët e komunitetve ngre nivelin e besimit në këto insitucione dhe rrjedhimisht edhe atë të llograidhënies.

9 Udhëzim Administrativ (MAPL) nr. 01/2015 për transparencë në komuna, Neni 12, pika 3. https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9898

10 Udhëzim administrativ për ueb faqet e institucioenve publike, Neni 6, pika 1. https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11007

11 Ligji për përdorimin e gjuhëve. https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2440

## Komunat të ofrojnë më shumë informata rreth proceseve të integrimit të shtetit në BE në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar se si ndikojnë procese në nivelin lokal

Duke pasur parasysh implikimet dhe rëndësinë e procesit të ingrimit në BE, dhe organizata të tjera ndërkombëtare, është e rëndësishme që komunat t`i mbajnë qytetarët të informuar rreth implikimeve të këtyre proceseve në përditshmërinë e qytetarëve. Njëkohësisht, kjo i ndihmon informimit dhe pjesëmarrjes qytetare në procese të rëndësishme për vendin.

## Funskionalizimi i këshillave lokale përmes një procesi transparent dhe publikimi i kontakteve të tyre

Një organizim i mirë dhe funksional i këshillave të fshatrave do ta lehtësonte komunikimin e komunave me qytetarët. Këtij organizimi do t`i ndihmonte njëjtë edhe transparenca e plotë në procesin e konsolodimit.. Informimi i qytetarëve rreth këtyre entiteteve rrjedhimisht do të kontribuonte një ngritjen e nivelit të llogaridhënies në insitucionet e qeverisjes lokale.

KDI është  Organizatë Joqeveritare (OJQ)  e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni **www.kdi-kosova.org**

Projekti është mbështetur nga:

British Embassy
Pristina